TERMOKOS
ngrohtorja e qytetit

Plani Zhvillimor i N.P
TERMOKOS SH.A.

2019-2029

Përmbajtja:

1. HYRJE 8

1.1. Roli dhe mandati i Operatorit të Sistemit të Shpërndrjes së energjisë termike 11

1.2. Objektivi i përgjithshëm i planifikimit afatgjatë të sistemit të shpërndarjes së energjisë termike 12

1.3. Përmbajtja e Planit zhvillimor 13

2. Gjendja ekzistuese 15

2.1. Kapacitetet për prodhimin e energjisë termike 15

2.2. Stabilimientet e Kogjenerimit në TC Kosova B 16

2.2.1. Rrjetit për transportimin e energjisë termike nga TC Kosova B deri në Termokos 16

2.2.2. Stacionit të ekstraktimit të energjisë termike në TC Kosova B 17

2.2.3. Kyçja në njësinë B1 dhe B2 me kapacitetet nominale nga 140 MWTH 18

2.2.4. Stacioni i pranimit të energjisë termike në NP "Termokos" 19

2.3. Përshkrimin i rrjetit të sistemit të shpërndarjes 20

2.4. Prodhimi, humbjet në rrjet dhe furnizimi / kërkesa aktuale 22

2.4.1. Energjia termike e ekstraktuar nga TC Kosova B, sipas sezonave. 23

2.5. Projektet e realizuara gjatë periudhës 2012-2018 24

2.5.1. Projekti i Kogjenerimit 24

2.5.2. Pakot tenderuese në kuadër të Projektit të kogjenerimit 24

2.5.3. Burimet Financiare të projektit: 24

2.5.4. Projektet investive të realizuara gjatë vitit 2016 25

2.5.4.1. Projekti T3 "Rehabilitimi i 50 termonënstacioneve" 25

2.5.4.2. Projekti T4 "Rehabilitimi i rrjetës së tubacioneve të ngrohjes në qytet" 25

2.5.5. Projektet investive të realizuara gjatë vitit 2018 26

3. Problemet dhe sfidat në rrjetin e shpërndarjes 27

3.1. Vjetërsia e gypave te ngrohjes 27

3.2. Rrjeti i pabalancuar 27

3.3. Vjetërsia e nënstacioneve 27

3.4. Vjetërsia e rrjetit sekondar 28

3.5. Kualitet më i dobët i ngrohjes në rajonin e Kodrës së Diellit 28

3.6. Pikat (segmentet) kritike të rrjetit të shpërndarjes 28

3.7. Mungesa e pompës së tretë në Stacionin e pranimit të nxehtësisë (HRS) 29
4. Analiza e konsumit të energjisë termike dhe parashikimi i kërkesës..... 30
4.1. Analiza 30
4.1.1. Konsumi aktual dhe paraprak..... 30
4.1.2. Kapaciteti i shfrytëzuar dhe në dispozicion 32
4.1.3. Faktorët ndikues në kërkesën për kapacitet dhe për energji termike 35
4.1.4. Përmirësimi i kualitetit të furnizimit..... 35
4.1.5. Projektet zhvillimore për zgjerimin e rrjetit..... 36
4.1.6. Rehabilitimi i rrjetit..... 37
4.1.7. Implementimi i faturimit bazuar në matjen e konsumit 38
4.1.8. Deponimi i ngrohjes..... 38
4.1.9. Kapaciteti në dispozicion (rezervë) 39
4.2. Parashikimi i Kërkesës për energji termike për periudhën 2018-2028 41
5. Planifikimi për zhvillimin e rrjetit / sistemit 42
5.1. Faktorët kryesor në planifikimin e projekteve zhvillimore 42
5.2. Objektivat e planit zhvillimor 42
5.3. Masat kryesore për arritjen e objektivave të Strategjisë janë: 43
5.3.1. Zvogëlimi i humbjeve dhe kursimi i energjisë 43
5.3.2. Masat e shfrytëzimit efiçient të energjisë termike 43
5.3.3. Masat prioritare për përmirësim të cilësisë së ngrohjes 44
5.3.4. Masat strategjike afatgjate 44
5.3.5. Kalimi në Faturim të bazuar në shpenzim..... 44
5.4. Metodologjia dhe kriteret për hartimin e Planit zhvillimor 45
5.5. Projektet e Planifikuara..... 46
5.5.1. Projektet për rehabilitimin dhe zgjerim të rrjetit..... 47
5.5.2. Projekti për rehabilitim dhe zgjerim të rrjetit (Komisioni Europian) 47
5.5.3. Projekti për rehabilitim dhe zgjerim te rrjetit (Qeveria Gjermane – KfW) 59
5.5.4. Projekti për instalimin e matësve të energjisë - MCC 59
5.5.5. Projekti për Zgjerimin e sistemit të pompave qarkulluese për rrjetin e shpërndarjes dhe rrjetin e transportit të energjisë termike 62
5.5.6. Projekti për implementimin e softuereve të reja 63

5.5.7. Projekti për ndërtimin e një objekti te ri për stafin Administrativ 64

5.5.8. Projekti për Furnizimin me energji termike përmes energjisë diellore 64

5.5.9. Projekti për ndërtimin e infrastrukturës për dyfishim të kapaciteteve prodhuese dhe rrjetit transmetues të kogjenerimit në 280 MW 67

5.5.10. Dizajni aktual 67

5.5.11. Koncepti teknik..... **Error! Bookmark not defined.**

Ekstraktimi i avullit në sallën e turbinave (B1+B2)..... **Error! Bookmark not defined.**

Transferimi i avullit në stacionet e HES përmes urës së gypave ..... **Error! Bookmark not defined.**

Prodhimi i ngrohjes në HES të ri (140 MW)..... 69

Transmetimi i ngrohjes përmes gypave të TC ..... **Error! Bookmark not defined.**

Stacioni i ri për pranimin e ngrohjes për 140 MW 70

Përmbajtja e tabelave:

Tabela: 1 Kapacitetet e prodhimit të energjisë termike nga kogjenerimi 15
Tabela: 2 Kapacitetet e stabilimenteve të prodhimit në ngrohtore 15
Tabela: 3 Karakteristikat kryesore të rrjetit të transportimit nga Sistemi i Kogjenerimit 16
Tabela: 4 Karakteristikat kryesore të rrjetit primar të shpërndarjes 20
Tabela: 5 Energjia e prodhuar, energjia e liferuar tek konsumatorët, humbjet në rrjet (rrjeti I transportit dhe i shpërndarjes) në sezonat 2015/16, 2016/2017 dhe 2017/2018. 22
Tabela: 6 Humbjet e energjisë termike në rrjetin e transportimit të energjisë termike nga kogjenerimi 23
Tabela: 7 Rehabilitimi I 50 nënstacioneve 25
Tabela: 8 Paraqitja e segmenteve në të cilat janë kryer punimet per rehabilitimin e rrjetës së tubacioneve 26
Tabela: 9 Ndërrimi i rrjetit gjatë vitit 2018 26
Tabela: 10 Pikat (segmentet) kritike të rrjetit të shpërndarjes 29
Tabela: 11 Energjia e prodhuar, liferuar dhe humbjet 30
Tabela: 12 Numri i konsumatorëve 30
Tabela: 13 Sipërfaqja ngrohëse 31
Tabela: 14 Konsumit specifik për sezonë 31
Tabela: 15 Kërkesa për kapacitet elektrike dhe termike 32
Tabela: 16 Të dhënat për sipërfaqen, kapacitetin dhe kërkesën për energji 35
Tabela: 17 Sipërfaqja e Kyçjeve të reja, kapaciteti dhe kërkesa shtesë për energji 36
Tabela: 18 Ngrohja në të ardhmen në rrjetin shpërndarës të qytetit 36
Tabela: 19 Vlerësimet e kapacitetit 40
Tabela: 20 Kapaciteti rezervë shtesë 40
Tabela: 21 Planifikimi për konsumin e energjisë dhe rritjen e sipërfaqes 41
Tabela: 22 Detaje të komponentës për zëvendësim të tubacioneve 48
Tabela: 23 Detajet e komponentës për zgjerimim të rrjetit 52
Tabela: 24 Detaje të komponentës për rehabilitim dhe modernizim të termonënstacioneve 56
Tabela: 25 Detajet e komponetes për zgjerimin e rrjetit – nënstacionet e reja 58
Tabela: 26 Projekti për vendosjen e matësve të energjisë 62
Tabela: 27 Projekti për Zgjerimin e sistemit të pompave qarkulluese 62
Tabela: 28 Projekti për implementimin esoftuereve 64
Tabela: 29 Projekti për ndërtimin e një objekti te ri për stafin Administrativ 64
Tabela: 30 Projekti për Furnizimin me energji termike përmes energjisë diellore 66
Tabela: 31 Projekti për dyfishim të kapaciteteve prodhuese 72

Përmbajtja e figurave:

Fig. 1 Skema e rrjetit të transportimit të energjisë termike nga Stabilimentet e Kogjenerimit 17
Fig. 2 Diagrami PID i stacionit HES 18
Fig. 3 Skema PID e ekstraktimit te avullit nga turbinat B1 dhe B2 19
Fig. 4 Skema PID e nenstacionit HRS 20
Fig. 5 Shtrirja e rrjetit të sistemit të shpërndarjes 21
Fig. 6 Diagrami i humbjeve të energjisë termike gjatë tre sezonave ngrohëse 2015/2016, 2016/2017 dhe 2017/2018 22
Fig. 7 Diagrami i Humbjeve të energjisë termike në rrjetin e kogjenerimit 23
Fig. 8 Energjia termike mujore (për sezonë) e dërguar në rrjetin e shpërndarjes së Termokosit 31
Fig. 9 Situata aktuale (faza 1) 33
Fig. 10 Kapacitetet termike mesatare mujore 33
Fig. 11 Kapaciteti i ngrohjes dhe temperaturat e jashtme më 30 janar 2016 34
Fig. 12 Kapaciteti I ngrohjes dhe temperaturat e jashtme më 23.12.2017 34
Fig. 13 Situata me IHS të kontrolluar dhe rrjet të balancuar (faza 2) 35
Fig. 14 Situata pas dendësimit dhe zgjerimit të rrjetit (faza 3) 37
Fig. 15 Situata pas rehabilitimit të rrjetit (faza 4) 37
Fig. 16 Situata pas implementimit të fakturimit të bazuar në shpenzim real (faza 5) 38
Fig. 17 Situata pas implementimit të deponimit (faza 6) 39
Fig. 18 Parashikimet e kërkesës për energji termike sipas fazave 39
Fig. 19 Zhvillimi I rrjetit 47
Fig. 20 Skema principiele e montimit të matësve të ngrohjes 61
Fig. 21 Skema principiele për leximin e matësve 61
Fig. 22 Lokacioni fillestar 65
Fig. 23 Lokacioni 65
Fig. 24 Profili fillestar 66
Fig. 25 Ekstraktimi I ngrohjes prej 280 MW_{th} në termocentralin Kosova B (B1+B2) 68
Fig. 26 Modifikimet e domosdoshme në gypat e avullit në sallën e turbinave për ekstraktimin e 280 MW_{th} 69
Fig. 27 Plani I shtrirjes me HES ekzistues dhe të ri në termocentralin Kosova B 70
Fig. 28 Transmetimi I ngrohjes prej 280 MW_{th} në rrjetin ekzistues të Termokosit 71
Fig. 29 Plani I shtrirjes me stacionin ekzistues dhe të ri në Termokos 72

Shkurtesat

NP- Ndërmarrja Publike

ShA -Shoqëri Aksionare

MZHE – Ministria e Zhvillimit Ekonomik

ZRRE – Zyra e Rregullatorit për Energji

KEK – Korporata Energjetike e Kosovës sh.a

KEDS - Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me energji elektrike

TI – Teknologjia Informative

KfW- Banka për zhvillim

EBRD- Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim

PCS/SCADA- Sistemi i Monitorimit dhe Kontrollimit në Distancë

EU- Unioni Europian,

MCC- Korporata Sfiduese e Mjëvjeçarit

PK- Projekti i Kogjenerimit

TC- Termocentral

HRS- Stacioni për pranim të nxehtësisë - Termokos

HES- Stacioni për nxjerrje të nxehtësisë - Kosova B

OSSH- Operatori i sistemit të shpërndarjes

STANET- Program për kalkulime hidraulike të rrjetit

QKUK- Qendra Klinike Universitare e Kosovës

MNQ -Matjet e ngrohjes qëndrore

Bashkangjitur me këtë dokument janë:

Aneksi 1 – Objektet për zgjerim të rrjetit në rrjetin ekzistues,
Aneksi 2 – Objektet për Zgjerim të rrjetit në rrjet të ri ,
Aneksi 3 – Lista e objekteve për dendësim të rrjetit.

1. HYRJE

Sektori i ngrohjes qendrore, është një ndër sektorët shumë të rëndësishëm, që ndikon në mirëqenjen e qytetarëve, ekonominë e vendit dhe mbrojtjen ambientale.

Ky sektor ka një shtrirje mjaft të kufizuar në shkallë vendore, që plotëson afërsisht 3 - 5% të kërkesës së përgjithshme për ngrohje në Kosovë. Sektori i Ngrohjes Qendrore në Kosovë përbëhet nga katër sisteme: NQ Termokos – Prishtinë, NQ Gjakova – Gjakovë, NQ Termomit – Mitrovicë, dhe në Zveçan. Sektori i amvisërisë dhe ai i shërbimeve janë sektorët më të mëdhenj të konsumit të energjisë termike për ngrohje.[1]

Sidoqoftë, ndër objektivat kryesorë të Strategjisë shtetërore, theksohet nevoja për rritjen e sistemeve të Ngrohjes Qendrore, e cila cilësohet si mjaft sfiduese dhe e rëndësishme për zhvillimin e sektorit të enegjisë në Kosovë.

Viteve të fundit janë zhvilluar disa projekte në sisitemin e ngrohjes së NP “Termokos” SH.A -Prishtinë, të cilat kanë ndikuar në furnizimin shumë më të mirë të konsumatorëve me ngrohje. Projekti i kogjenerimit për furnizim me energji termike nga TC “Kosova B” dhe rehabilitimi i rrjetit dhe nënstacioneve termike, kanë mundësuar furnizim më cilësor të konsumatorëve ekzistues dhe mundësi e lartë për kyçje të konsumatorëve të rinjë.

Në vitin 2018 është finalizuar Master Plani për zgjerimin dhe modernizimin e rrjetit të ngrohjes qëndrore në qytetin e Prishtinës. Përmes këtij plani janë propozuar disa skenarë për rritjen e energjisë termike në dispozicion nga sistemi i kogjenerimit, rehabilitimin dhe zgjerimin e rrjetit primarë si dhe shumë aspekte tjera të ndërlidhura me këtë çështje.

Rekomandimet nga ky plan pritet të zbatohen përmes projekteve të financuara nga donatorë të ndryshëm (KfW, EU, MCC etj.), të cilat janë në fazën përfundimtare të përgaditjes për implementim apo planifikohen për vitet në vijim.

Prandaj, fakti i posedimit të një udhërrëfyesi për orientimin e investimeve në të ardhmen, në atë mënyrë që ndër të tjera të sigurohet edhe qëndrueshmëria teknike dhe financiare, determinon në përgaditjen e një Plani Zhvillimor afatgjatë.

[1] Bazuar në dokumentin Startegjia e energjisë e Republikës së Kosovës (2017-2026)

Veprimtaria e ndërmarrjes

NP "Termokos" Sh.A. është i vetmi furnizues lokal për ngrohje qëndrore në Prishtinë. Veprimtaria e saj mbështet kryesisht në Ligjin për energji termike si dhe në Rregulloret e ZRRE-së.

Ndërmarrja është e licencuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë, për veprimtaritë:

a) Prodhimi i energjisë termike ;
b) Distribuimi (shpërndarja) i energjisë termike ;
c) Furnizimi i konsumatorëve me energji termike ;

N.P."Termokos"sh.a. është e pajisuar me tri licenca nga ZRRE:

1. Licencë për Prodhim të energjisë termike, me Nr. ZRRE/Li_02/17 (afati i vlefshmërisë deri 04.10.2020)
2. Licencë për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes së energjisë termike, me Nr. ZRRE/Li_03/17 (afati i vlefshmërisë 04.10.2020)
3. Licencë për Furnizim Publik me energji termike, me Nr. ZRRE/Li_04/17 (afati i vlefshmërisë 04.1 0.2035)

Baza Juridike për hartimin e Planit Zhvillimor të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Termike

Ligji për Energjinë

Çdo vit, Operatori i Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Termike dhe Operatori i Sistemit të Transmetimit të Gazit Natyror, i dorëzojnë Zyrës së Rregullatorit për Energji Planin dhjetë (10) vjeçar për zhvillimin e rrjetit në bazë të kërkesës dhe furnizimit aktual dhe të parashikuar pas konsultimit më të gjithë akterët relevant.

Plani i zhvillimit të rrjetit përmbanë masa efikase në mënyrë që të garantojë përshtatshmërinë e sistemit dhe sigurinë e furnizimit, duke përshirë si në vijim:

- njofton pjesëmarrësit kryesor të tregut për infrastrukturën që nevojitet të ndërtohet apo të përmirësohet gjatë dhjetë (10) vjetëve të ardhshme;

- të gjitha investimet që janë në zhvillim dhe identifikon investimet e reja që do të ekzekutohen gjatë periudhës 10 vjeçare dhe

- ofron një kornizë kohore për të gjitha projektet e investimeve në periudhën 10 vjeçare.

Licencë për operatorin e sistemit të shpërndarjes së energjisë termike

- Në përputhje me Nenin 15 të Ligjit për Energjinë Termike, i Licencuari do të hartojë dhe publikojë Planet Zhvillimore afatshkurta dhe afatgjata për zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes dhe t'i koordinojë planet e tilla me Ministrinë përkatëse dhe me institucionet komunale përkatëse. I Licencuari do t'iu lë në dispozicion ndërmarrjeve gjeneruese të energjisë termike për ngrohje si dhe furnizuesit(ve) planet dhe analizat e veta studimore.

- Në Përputhje me Nenin 10 të Ligjit për Energjinë, Nenin 15 të Ligjit për Energjinë Termike dhe Nenin 12 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, i Licencuari do të përgatisë Planin Zhvillimor afatshkurtër (3 vjeçar) dhe afatgjatë (10 vjeçar) të Sistemit të Shpërndarjes, dhe të dorëzojë në ZRRE për aprovim.

- I Licencuari do të rishikojë planin zhvillimor çdo vit, në mënyrë që informacioni i paraqitur në planin zhvillimor, të vazhdojnë të jenë i saktë në të gjithë aspektet materiale. Propozimet eventuale për plotësimin apo ndryshimin e Planit Zhvillimor do t'i dorëzojë ZRRE-së për aprovim.

Ligji për energjinë termike

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes në kuadër të veprimtarisë së vet:

- përgatit plane vjetore afatshkurta dhe afatgjata të zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes dhe koordinon projekte me Ministrinë dhe komunat;

Rregulla për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë

Aplikuesi që aplikon për marrjen e licencës për shpërndarjen e energjisë elektrike, energjisë termike dhe gazit natyror, përveç kërkesave të aplikueshme sipas nenit 8 te kesaj rregulle, duhet të dorezoj në Rregullator Planin zhvillimor të sistemit.

1.1. Roli dhe mandati i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së energjisë termike

Operatori i Sistemit të shpërndarjes së energjisë termike është i obliguar që të kryejë operim efikas, ekonomik dhe të koordinuar të sistemit të shpërndarjes së energjisë termike në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Për rrjetin e shpërndarjes përkujdeset Operatori i Sistemit të Shpërndarjes që posedon licencë për kryerjen e aktiviteteve të shpërndarjes së energjisë termike.

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, për territorin e caktuar dhe të mbuluar nga rrjeti i shpërndarjes kryen, shërbimet si në vijim:

- menaxhon rrjetin e shpërndarjes;
- mirëmban rrjetin dhe objektet në pajtim me kërkesat teknike;
- harmonizon projektet e veta me projektet për zhvillim ekonomik dhe urban të komunës;
- parashikon kërkesat për energji termike në harmoni më projektet e veta për zhvillim ekonomik dhe urban të komunës;
- bartë në mënyrë të vazhdueshme dhe të sigurt energjinë termike përmes rrjetit të shpërndarjes;
- informon shfrytëzuesit e rrjetit me informata që iu nevojiten për qasje efikase në rrjet, si dhe shërbime tjera përkatëse.
- shqyrton planet për projekte të zgjerimit të rrjetit të shpërndarjes në pajtim me parametrat e zhvillimit ekonomik dhe urban të komunës;
- përgatit plane vjetore afatshkurta dhe afatgjata të zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes dhe koordinon projekte me Ministrinë dhe komunat;
- bashkëpunon më Ministritë dhe komunat në përgatitjen e planeve, programeve dhe strategjive zhvillimore;
- vë në dispozicion të ndërmarrjeve prodhuese të energjisë termike, planet dhe analizat e veta studimore.
- Operatori i Sistemit të Shpërndarjes lejon prodhuesin tjetër të energjisë termike që të kyçet në sistemin e rrjetit të shpërndarjes nëse janë plotësuar kushtet teknike, si dhe kërkesat tjera të parapara me dispozitat e ligjit për energji termike dhe akteve tjera përkatëse.
- Zgjerimi dhe rindërtimi i rrjetit të shpërndarjes të energjisë termike që nga pika e furnizimit deri tek prodhuesi i energjisë termike është nën përgjegjësinë e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.
- Operatori i Sistemit të Shpërndarjes kyçë në rrjetin e shpërndarjes cilindo prodhues që prodhon energji termike nga burimet e ripërtëritshme të energjisë dhe bashkëprodhimit.
- Kushtet dhe procedurat për kyçje në rrjetin e shpërndarjes rregullohen me kodin e shpërndarjes.
- Operatori i Sistemit të Shpërndarjes vepron në pajtim me procedurat transparente, jodiskriminuese dhe të bazuara në parimet e ekonomisë së tregut.
- Operatori i Sistemit të Shpërndarjes obligohet të bëjë instalimin e pajisjeve matëse të ngrohjes të cilat mundësojnë leximin e rregullt të konsumit të energjisë.

1.2. Objektivi i përgjithshëm i planifikimit afatgjatë të sistemit të shpërndarjes së energjisë termike

Për të plotësuar kërkesat në rritje të qytetit të Prishtinës për energji termike, Termokosi planifikon zgjerimin dhe modernizimin e sistemit të energjisë termike. Në këtë drejtim, projektet kryesore të finacuara nga donatorë dhe nga mjetet vetanake, janë:

- Rehabilitimi i 360 nënstacioneve nga 410 eksistuese. Rehabilitimi nënkupton ndërrimin e këmbyesve të nxehtësisë dhe pompave qarkulluese, instalimin e sistemit rregullues dhe atij për matje të energjisë termike.
- Ndërrimi i rrjetit shpërndarës në gjatësi prej 17km trasë (34 km gyp). Janë identifikuar pozicionet kritike, kryesisht në rrjetin magjistral dhe degëzimet kryesore, aty ku mendohet se humbjet e ujit dhe energjisë janë më të mëdha.
- Zgjerimi i rrjetit të ngrohjes në lagjet e reja, të cilat do të vlerësohen pas analizës hidraulike të rrjetit dhe rezevave energjetike në pozicione të caktuara. Këto analiza është duke i bërë konsulenca e angazhuar nga BE, në bashkëpunim me Termokosin dhe Komunën e Prishtinës.
- Sipas Master Planit, planifikohet rritje e sipërfaqes shtesë rreth 100%, e cila do të kyçet në rrjetin e Termokosit. Kështu që në fund të periudhës 10 vjeçare sipërfaqja ngrohëse do të arrijë deri në 2,511,537 m².

Këto investime kanë për synim rritjen e përformancës së kompanisë, duke pasur një komponentë të rëndësishme zgjerimin dhe modernizimin e rrjetit shpërndarës, zvogëlimin e humbjeve të energjisë, ndërtimin e termo-nënstacioneve të reja dhe optimizimin e punës së sistemit të shpërndarjes së energjisë termike (balancimi i sistemit, matja dhe faturimi sipas shpenzimit, etj).

Zvogëlimi i humbjeve dhe kursimi i energjisë

Projektet që planifikohen të realizohen në kuadër të këtij Plani Zhvillimor, përveç objektivave të potencuara më lartë, kanë për qëllim zvogëlimin e humbjeve të energjisë në rrjet dhe kursimin e saj përmes masave të efiçiencës.

Zvogëlimi i humbjeve të ujit

Humbjet e ujit në rrjetin e shpërndarjes janë ende të mëdha dhe ndikojnë drejtpërdrejt në kualitetin e shërbimit dhe përformancën e ndërmarrjes, si dhe në nivelin e tërësishëm të humbjeve në rrjet. Objektiv i Termokosit është që këto humbje të ujit nga rreth 11% që aktualisht janë humbjet ditore , në fund të kësaj periudhe të zbriten nën 8%.
Me zvogëlimin e humbjeve, rrjedhimisht me kursimin e energjisë do të rritet mundësia që Termokosi, me të njëjtat kapacitetete, të furnizoj më shumë konsumatorë.

Masat e shfrytëzimit efiçient të energjisë termike

Është evidente se në këtë drejtim ka shumë mundësi të përmirësohet efiçienca e energjisë. Projektet e planifikuara, të cilat do të ndikojnë në këtë çështje janë:

- Rehabilitimi i nënstacioneve termike.
- Rehabilitimi i nënstacioneve nënkupton edhe marrjen e të gjitha masave për aftësimin e rregullimit automatik dhe matjes së energjisë termike. Në këtë mënyrë do të bëhet balancimi hidraulik dhe energjetik i rrjetit dhe si rezultat i kësaj, do të arrihet furnizimi i të gjithë konsumatorëve me energji të nevojshme sipas standardeve.
- Gypat e paraizoluar të cilët do të instalohen në rrjetin e rehabilituar, përveç zvogëlimit të humbjeve të ujit, do të ndikojnë edhe në zvoglimin e humbjeve të energjisë si rezultat i izolimit termik të gypave sipas standardeve.

Përmirësimi i termoizolimit të objekteve të vjetra, publike dhe private është një mundësi e mirë për kursim të energjisë termike. Konsumatorët e rinjë, të cilët planifikohen të lidhen në rrjetin e Termokosit, kanë standard të pranueshëm sa i përket termoizolimeve. Në këtë drejtim, duke pasur në rrjetin e vet konsumatorë të cilët i plotësojnë standardet e efiçiencës termike, Termokosi e sheh mundësinë e rritjes së numrit të konsumatorëve duke shfrytëzuar të njëjtat potenciale gjeneruese.

1.3. Përmbajtja e Planit zhvillimor

Plani zhvillimor i NP"Termokos"SH.A, është përpiluar në pajtim me Dokumentin udhëzues për hartimin e Planit zhvillimor të Sistemit të shpërndarjes së energjisë termike, hartuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE).

Plani zhvillimor, përfshinë periudhën dhjetëvjeçare dhe duhet të azhurnohet çdo vit. Ky dokument hartohet për herë të parë në këtë format dhe paraqet planifikimin e parë për një periudhë afatgjate (dhjetëvjeçare) për zhvillim të sistemit të energjisë termike.

Të dhënat e paraqitura në këtë Plan zhvillimor, janë të bazuara në të dhënat historike të sezonave të fundit, në projeksionet zhvillimore aktuale dhe në dokumentet (strategjitë, studimet) relevante të cilat i përmbanë edhe Master Plani.

MASTER PLANI (Përmirësimi i Sistemit të Ngrohjes Qëndrore në Prishtinë)- është një dokument i përgaditur për "N.Q."Termokos" Prishtinë. Master Plani është punuar nga konsulenca "ECH/ iC Consulenten" dhe financuar nga KfW, ndërsa është aprovuar në janar të vitit 2018. Master Plani ka caktuar mundësitë e zgjerimit të rrjetit dhe rritjen e kapaciteteve të ngrohjes për qytetin e Prishtinës.

Komponentët kryesorë të Planit Zhvillimor

Kapitujt kryesorë të këtij Plani Zhvillimor janë:

1. Hyrje
1.1. Roli dhe mandati i operatorit të sistemit të energjisë termike
1.2. Objektivi i përgjithshëm i planifikimit afatgjatë të sistemit të shpërndarjes së energjisë termike
1.3. Përmbajtja e planit zhvillimor
2. Gjendja ekzistuese
2.1. Kapacitetet për prodhimin e energjisë termike
2.2. Përshkrimi i rrjetit të energjisë termike
2.3. Prodhimi, humbjet në rrjet dhe furnizimi / kërkesa aktuale
2.4. Projektet e vitit aktual
3. Problemet dhe sfidat në rrjetin e shpërndarjes
4. Analiza e konsumit të energjisë termike dhe parashikimi i kërkesës
4.1. Analiza e konsumit aktual dhe paraprak
4.2. Parashikimi i kërkesës për periudhën planifikuese
5. Planifikimi për zhvillimin e rrjetit / sistemit
5.1. Metodologjia dhe kriteret për hartimin e planit zhvillimor
5.2. Projektet e planifikuara

2. Gjendja ekzistuese

NP "Termokos" Sh.A. është furnizuesi i vetëm i ngrohjes qendrore në Prishtinë. Krahas ngrohjes qendrore, NP "Termokos" Sh.A. gjithashtu ofron edhe shërbime të mirëmbajtjes të sistemit të ngrohjes qendrore për konsumatorët e saj. Kërkesa për ngrohje qendrore e ofruar nga NP 'Termokos" Sh.A. është jashtëzakonisht e lartë. Kjo për arsye se NP "Termokos" Sh.A. ofron ngrohje kualitative 24 orë gjatë sezonit ngrohës gjashtëmujor me çmim të arsyeshëm të ngrohjes.

NP "Termokos" Sh.A. ofron ngrohje për 13,459 konsumatorë (prej të cilëve 12,299 janë konsumator të amvisërisë dhe 1,160 konsumator komercial e institucional). Bazuar në dokumentin e Masterplanit të realizuar në vitin 2018, rezulton që sipërfaqja potenciale e konsumatorëve të rinj që do të mund të kyçen në sistemin e ngrohjes së NP "Termokos" Sh.A. është rreth 1,200,000m^2. Kjo dërgon drejt konkluzionit që NP "Termokos" Sh.A., mund të ofrojë ngrohje qendrore për afro 13.500 konsumatorë të rinj, të kategorive të ngjashme me konsumatorët ekzistues, gjegjësisht një bazë konsumatorësh banesor dhe afarist.

2.1. Kapacitetet për prodhimin e energjisë termike

Njësi bazë gjeneruese e energjisë termike është TC Kosova B, përmes sistemit të kogjenerimit me kapacitet prej 140 MW_{TH}. Për prodhimin e energjisë termike shfrytëzohet avulli i cili ekstraktohet përmes dy turbinave në këtë termocentral. Këmbimi i energjisë avull/ujë bëhet në stacionin për ekstraktim të energjisë HES, përmes dy këmbyesve me kapacitet nga 70MW_{TH}. Ky stacion është në afërsi të TC Kosova B, dhe në tërësi menaxhohet nga Termokosi.

Njësia gjeneruese	Kapaciteti i instaluar	Kapaciteti operativ	Viti i prodhimit/instal.	Vendi
Sistemi i kogjenerimit - TC Kosova B	2x70MW_{TH} =140 MW_{TH}	137.4MW_{TH}	2014	TC Kosova B

Tabela: 1 Kapacitetet e prodhimit të energjisë termike nga kogjenerimi

Termokos-i disponon edhe me kapacitete të veta të prodhimit të energjisë termike, kaldajat me lëndën djegëse mazut, të cilat janë përdorur para funksionalizimit të sistemit të kogjenerimit. Këto njësi prodhuese janë funksionale dhe mund të përdoren në raste specifike (mbulimi i kërkesave të energjisë në pikun e ngarkesës, dhe në rast të ndërprerjes së furnizimit nga KEK – TC Kosova B,).

Njësia gjeneruese	Kapaciteti instalues	Shkalla e shfrytëzimit η (%)	Kapaciteti në dispozicion	Lënda djegëse	Konsumi i lëndës djegëse Kg/ MWh	Viti i prodhimi/ instalimit	Vendi
Kaldaja Me ujë të nxehtë	2x58= 116MW_{TH}	85	98.6 MW_{TH}	Mazut	105	1978	Termokos
	2x7= 14 MW_{TH}	90	12.6 MW_{TH}	Dizel	96	1983	Ngrohtorja e QKUK
	4 MW_{TH}	90	3.6 MW_{TH}	Mazut	96	2003	Termokos
Total Kapaciteti	134 MW_{TH}	-	114.8 MW_{TH}	-	-	-	-

Tabela: 2 Kapacitetet e stabilimenteve të prodhimit në ngrohtore

2.2. Stabilimentet e Kogjenerimit në TC Kosova B

Në nëntor të vitit 2014, Termokosi ka filluar furnizimin e konsumatorëve me energji termike të prodhuar përmes sistemit të kogjenerimit. Përmes këtij sistemi është bërë e mundur shfrytëzimi i energjisë termike nga avulli i turbinave të blloqeve B1 dhe B2 të TC "Kosova B". Kapaciteti termik i instaluar nga ky sistem, është 2x70=140MW_{TH} termik. Mirëpo kapaciteti i këmbyesëve 2x70MW_{TH} në stacionin për ekstraktim të energjisë (HES) dhe aftësia bartëse e termopërçuesit TC "Kosova B" – "Termokos", DN600 (rreth 160 MWTH), aktualisht e limitojnë mundësinë e shfrytëzimit të kësaj energjie me fuqi termike deri në 140 MWTH.

Projekti i Kogjenerimit ka ndikuar që Termokosi të shëndrrohet në një kompani me standarde teknike dhe financiare të qëndrueshme, duke fituar besushmërinë e konsumatorëve të saj. Njëkohësisht, impakt shumë i rëndësishëm i këtij projekti është mbrojtja e mjedisit dhe zvoglimi i emisionit të gazrave në atmosferë. Aktualisht, në sistemin e ngrohjes qëndrore të Termokosit janë të kyçur konsumatorë, fuqia e instaluar e të cilëve (sipas Master Planit të vitit 2018) është rreth 117 MW_{TH}.

Rrjeti i Transportimit të energjisë termike KEK-Termokos			
Ngrohtorja e Prishtinës	Numri i Stacioneve	Gjatësia e tubacionit të rrjetit (km)	Numri i matësve te energjisë
	2 stacione termike: **HRS** (stacioni për pranim të nxehtësisë- Termokos) **HES** (stacioni për nxjerrje të nxehtësisë-Kosova B)	11.5x2=23	Në HES dy matës :SCYLAR INT M Në HRS : • një matës para këmbyesve • një matës pas këmbyesve • një matës per degëzimin Kodra e Diellit

Tabela: 3 Karakteristikat kryesore të rrjetit të transportimit nga Sistemi i Kogjenerimit

2.2.1. Rrjeti për transportimin e energjisë termike nga TC Kosova B deri në Termokos

Ky rrjet, i cili ka gjatësi 11.5km trasë, mundëson transportimin e energjisë termike nga nënstacioni për ekstraktim të nxehtësisë HES (TC Kosova B) deri te nënstacioni për pranim të nxehtësisë HRS (Termokos). Rrjeti është i përbërë nga gypa të çelikut të paraizoluar, me diametër nominal DN600mm. Përgjatë trasesë, në pika karakteristike, janë të ndërtuara katër puseta, të cilat shërbejnë për kontrollë dhe mirëmbajtje të rrjetit. Në të njejtin kanal, është i instaluar edhe kablli optik, përmes të cilit bëhet e mundur ndërlidhja, kontrolli dhe komandimi i nënstacionit HES, nga Termokosi.

Në figurën më poshtë është paraqitur skema e rrjetit të Kogjenerimit



Fig. 1 Skema e rrjetit të transportimit të energjisë termike nga Stabilimentet e Kogjenerimit

2.2.2. Stacioni i ekstraktimit të energjisë termike në TC Kosova B

Stacioni për ekstraktim të energjisë (HES) është i ndërtuar afër TC Kosova B, dhe mundëson nxjerrjen e avullit nga turbinat B1 dhe B2 të kësaj termoelektrane. Në stacion janë të instaluar dy kondenzatorë (këmbyes avull / ujë) me fuqi të instaluar 140MW_{TH} (2x70MW_{TH}), sistemi për kthim të kondenzatit si dhe të gjitha pajisjet tjera për rregullim dhe komandim të sistemit. Në këtë stacion bëhet edhe matja e energjisë së ekstarktuar. Sipas kësaj matje, bazuar në marrëveshjen për blerje të energjisë termike, bëhet edhe pagesa ndaj KEK-ut për energjinë e shfrytëzuar.

Parametrat dizajnues për Stacionin për ekstraktim të energjisë (HES) janë:

Temperatura e dizajnuar T_d = 150^oC; Presioni i dizajnuar Pd=20.8bar; Temperatura operuese T_o = 120^oC , Presioni operues P_o=19bar; Presioni testues Pt=29.7bar; Presioni nominal PN =25 bar.

Parametrat dizajnues të kondenzatorëve me presion të lartë:

Temperatura e dizajnuar T_d = 150^oC; Presioni i dizajnuar Pd=25bar; Temperatura operuese T_o = 100^oC , Presioni operues P_o=21bar; Presioni testues Pt=39.3bar; Presioni nominal PN =25 bar.



Fig. 2 Diagrami PID i stacionit HES

2.2.3. Kyçja në njësinë B1 dhe B2 me kapacitetet nominale nga 140 MW_{TH}

Sistemi për ekstraktim të energjisë termike është i kyçur në të dy turbinat e TE Kosova B (në mes të turbinës së shkallës me presion të mesëm dhe asaj të ulët). Bazuar në dizajn, por edhe në testet e bëra pas përfundimit të projektit, është vlerësuar si opcion i mundëshëm ekstraktimi i fuqisë 140MW_{TH} termik nga secila turbinë, me disa modifikime shtesë, që mundëson disa skenarë të nxjerrjes së avullit, varësisht nga statusi i punës së turbinave (furnizim nga të dy turbinat, apo përmes gypit lidhës, nga njëra apo tjetra turbinë).

Parametrat dizajnues të avullit me presion të ulët :

Temperatura e dizajnuar: T_d = 300^oC; Presioni i dizajnuar: Pd= -1/+6 bar; Temperatura operuese: T_o=285^oC , Presioni operues: P_o=2.2bar; Presioni nominal: PN =16bar.



Fig. 3 Skema PID e ekstraktimit te avullit nga turbinat B1 dhe B2

2.2.4. Stacioni i pranimit të energjisë termike në NP "Termokos"

Në Termokos është ndërtuar stacioni për pranim të nxehtësisë HRS. Në këtë stacion janë të instaluar tre këmbyes të nxehtësisë (ujë/ujë) me fuqi 3x50MW$_{TH}$ termik, dy pompa për qarkullim të ujit në rrjetin e kogjenerimi me kapacitet nga 1,300m³/h, sistemi për mbajtje të shtypjes në rrjet, sistemi për zbutje të ujit si dhe sistemi për kontrollë dhe udhëheqje të punës (vizualizim përmes SCADA sistemit).

Parametrat dizajnues të Stacionit për pranim të nxehtësisë (HRS) janë:

<u>Parametrat në pranim:</u>

Temperatura e dizajnuar T_d = 150^{o}C; Presioni i dizajnuar Pd=20.8bar; Temperatura operuese T_o = 120^{o}C , Presioni operues P_o=19bar; Presioni testues Pt=29.7bar; Presioni nominal PN =25 bar.

<u>Parametrat në kthim:</u>

Temperatura e dizajnuar T_d = 150^{o}C; Presioni i dizajnuar Pd=22 bar; Temperatura operuese T_o = 120^{o}C , Presioni operues P_o=21bar; Presioni testues Pt=31.5bar; Presioni nominal PN =40 bar.



Fig. 4 Skema PID e nenstacionit HRS

2.3. Përshkrimin i rrjetit të sistemit të shpërndarjes

Sistemi i shpërndarjes së ngrohjes qendrore në Prishtinë përbëhet nga rrjeti primar i shpërndarjes, që shtrihet deri në pikën e furnizimit në nënstacione, dhe nga rrjeti sekondar i cili shtrihet nga pika e furnizimit në nënstacione gjer tek shfrytëzuesit final.

Rrjeti primar i shpërndarjes i NP “Termokos” ShA ka një gjatësi tubacioni prej rreth 77km . Pjesë integrale e rrjetit të shpërndarjes janë edhe dy termonënstacione në rrjetin primarë, të cilët gjendet në Kodrën e Diellit (stacioni i këmbyesve në lagjen Kodra e Diellit tek Fakulteti Teknik dhe grupi i nënstacioneve tek blloqet e vjetra), si dhe 395 nënstacione aktive të cilat janë pika ndarëse ndërmjet rrjetit primar dhe sekondar.

Rrjeti i Shpërndarjes dhe Nënstacionet			
Ngrohtorja e Prishtinës	Numri i Nënstacioneve	Gjatësia e tubacionit të rrjetit (km)	Numri i matësve në termonenstacione
	411 total (395 aktive dhe 16 pasive)	77.00	Nga 395 nënstacione aktive në 285 janë të vendosur matësit dhe janë funksional, kurse në 110 nënstacione nuk ka matës

Tabela: 4 Karakteristikat kryesore të rrjetit primar të shpërndarjes

Rrjeti primar i shpërndarjes me gjatësi të tubacionit prej 77 km dhe vëllim të ujit prej 3,500 m^3, është i instaluar kryesisht në vitet e 70-ta, në pjesën e urbanizuar të Prishtinës. Përkundër investimeve, posaçërisht në vitin e fundit, rreth 50% e rrjetit është me gypa të rinjë të paraizoluar, kurse pjesa tjetër e rrjtit është me gypa të vjetër dhe të amortizuar.

Rrjeti është i shpërndarë në këto rajone :

- Rajoni i Dardanisë
- Rajoni i Qendrës
- Rajoni i Ulpianës
- Rajoni i Kodrës së Diellit
- Rajoni i Spitalit
- Rajoni i Kalabrisë (Emshirit) ka vetëm dy nënstacione, por është e paraparë të përfshihet në planin për zgjerim të rrjetit me projektin e Komisionit Europian dhe projektet tjera.

Në figurën më poshtë është paraqitur skema e rrjetit të shpërndarjes.



Fig. 5 Shtrirja e rrjetit të sistemit të shpërndarjes

2.4. Prodhimi, humbjet në rrjet dhe furnizimi / kërkesa aktuale

Në vijim, në mënyrë tabelare dhe grafike janë paraqitur të përmbledhura të dhënat e prodhimit dhe furnizimit me ngrohje, si dhe humbjet në rrjetin e transportit dhe shpërndarjes së energjisë termike për tri sezonat ngrohëse : 2015/2016, 2016/2017 dhe 2017/2018.

Në sezonin 2017/2018 gjenerimi i ngrohjes ka qenë 223,738.00 MW_{TH} apo 1% më i vogël se sa në sezonin e kaluar 2016/2017 dhe për 13% më i madh se sa në sezonin 2015/2016. Ndërsa, liferimi i energjisë termike deri tek konsumatorët në sezonin 2017/2018 ka qenë 199,861.75 MW_{TH}, rrespektivisht 2% më i madh se sa në sezonin 2016/2017 dhe 21% më i madh krahasuar me sezonin 2015/2016. Pastaj, humbjet e energjisë termike në ketë sezonë 2017/2018, kanë qenë 11%, përderisa në dy sezonet e kaluara kanë qenë 13% dhe 17%.

Sezona	Te prodhuara MWh_{TH}	Te liferuara MWh_{TH}	Humbjet MWh_{TH}	Humbjet %
2015/2016	198,686.00	165,087.45	33,598.55	17%
2016/2017	225,438.00	196,462.20	28,975.80	13%
2017/2018	223,738.00	199,861.75	23,876.25	11%

Tabela: 5 Energjia e prodhuar, energjia e liferuar tek konsumatorët, humbjet në rrjet (rrjeti i transportit dhe i shpërndarjes) në sezonat 2015/16, 2016/2017 dhe 2017/2018.



Fig. 6 Diagrami i humbjeve të energjisë termike gjatë tre sezonave ngrohëse 2015/2016, 2016/2017 dhe 2017/2018

2.4.1. Energjia termike e ekstraktuar nga TC Kosova B, sipas sezonave.

Bazuar në matjet e bëra në TC Ksova B dhe në Termokos, humbjet mesatare të energjisë termike në rrjetin e transportimit TC Kosova B -Termokos, gjatë katër sezonave të fundit kanë qenë 2.1%.

Sezona	Te prodhuara MWh_{TH}	Te liferuara MWh_{TH}	Humbjet ne rrjetin e kogjenerimit MWh_{TH}	Humbjet ne rrjetin e kogjenerimit %
2014/2015	152,397.00	149,806.00	2,591.00	1.7%
2015/2016	198,696.00	193,340.00	5,356.00	2.8%
2016/2017	225,438.00	220,078.00	5,360.00	2.4%
2017/2018	223,738.00	219,954.00	3,784.00	1.7%
Total	**800,269.00**	**783,178.00**	**17,091.00**	**2.1%**

Tabela: 6 Humbjet e energjisë termike në rrjetin e transportimit të energjisë termike nga kogjenerimi



Fig. 7 Diagrami i Humbjeve të energjisë termike në rrjetin e transportimit të energjisë termike nga kogjenerimi

2.5. Projektet e realizuara gjatë periudhës 2012-2018

2.5.1. Projekti i Kogjenerimit

Projekti i kogjenerimit paraqet një investim kapital shumë të rëndësishëm dhe përfshinë këto komponente:

- Ndërtimi i rrjetit të transportit të energjisë termike – gypsjellësi TC Kosova B - NP "Termokos" ;
- Kyçja në njësinë B1 dhe B2 me kapacitetet nominale 2x70 = 140 MW_{TH};
- Ndërtimi i stacionit të ekstraktimit të energjisë termike në TC Kosova B (këmbyesi i nxehtësisë dhe pajisjet përkatëse të kyçjes në turbina);
- Ndërtimi i stacionit të pranimit të energjisë termike në NP "Termokos" Sh.A. (këmbyesi i nxehtësisë dhe pajisjet përkatëse të kyçjes në rrjetin e shpërndarjes);
- Zëvendësimi i gypave të vjetër me gypa të ri të paraizoluar;
- Rehabilitimi komplet i 50 nënstacioneve të sistemit të ngrohjes dhe instalimi i matësve të energjisë;
- Zgjerimi i rrjetit për lidhje të reja për konsumatorët e rinj;
- Instalimi i sistemit për monitorim dhe kontroll të nënstacioneve nga distanca.

2.5.2. Pakot tenderuese në kuadër të Projektit të kogjenerimit

- Paketa Tenderuese 1 - Tubacioni i Transmisionit 11km, e përfunduar në vitin 2014;
- Paketa Tenderuese 1A - ''T1A Sanimi i defekteve''
- Paketa Tenderuese 2 - Nxjerrja e nxehtësisë dhe stacionet lidhëse të ngrohjes – B1 e përfunduar në vitin 2014 ndërsa, B2 në vitin 2015;
- Paketa e tenderit: 3 – rehabilitimi i nënstacioneve (50 nënstacione), e përfunduar në 2016,
- Paketa e tenderit 4 – Rehabilitimi i rrjetit –pjesa më e madhe ka përfunduar në vitet 2016, 2017 dhe 2018, kurse pjesa e mbetur pritet të përfundojë në vitin 2019;
- Paketa e tenderit 5 – Materialet rezervë për PK,
- Paketa e tenderit 6 – Prioritetet për softuerë dhe tjera ,
- Paketa e tenderit për MASTER PLAN.

2.5.3. Burimet Financiare të projektit:

Projekti është realizuar përmes KfW-së dhe kap vlerën e investimeve prej 37 milion euro, të financuara nga:

- Bashkimi Evropian: 13.825 milion euro – Grant
- Banka Gjermane për Zhvillim/Kfw : 11 milion euro (6 mil Grant dhe 5 mil kredi)
- Qeveria e Suedisë: 1.9 milion euro - grant
- Qeveria e Luksemburgut: 1.47 milion euro - grant
- Komuna e Prishtinës : 2 milion euro – Grant

Fonde shtesë sipas Marrëveshjes së veçantë për Projektin e Kogjenerimit:

- Banka Gjermane për Zhvillim/Kfw : 4 milion euro grant
- Qeveria e Kosovës: 1.2 milion euro - grant
- Komuna e Prishtinës : 1.8 milion euro - grant .

2.5.4. Projektet investive të realizuara gjatë viteve 2016 – '17

Gjatë viteve 2016 – '17 janë realizuar Projektet T3 dhe T4, të cilët paraqesin investimet e parashikuara në kuadër të projektit të kogjenerimit, të realizuara me financim nga Qeveria Gjermane përmes Bankës Gjermane për Zhvillim / KfW.

2.5.4.1. Projekti T3 "Rehabilitimi i 50 termonënstacioneve"

Rehabilitimi dhe modernizimi i 50 nënstacioneve të energjisë termike në rrjetin e shpërndarjes, që përveç instalimit të pajisjeve mekanike dhe elektrike, ka përfshirëedhe instalimin e Sistemit të Monitorimit dhe Kontrollimit në Distancë (PCS/SCADA) në këto nënstacione dhe integrimin e tyre në sistemin qendror (PSC/SCADA), i cili mundëson marrjen e të dhënave në formë elektronike dhe monitorimin në distancë të nënstacioneve.
Në trabelën më poshtë është paraqitur numri i termonënstacioneve të rehabilituara të pasqyruara sipas rajoneve.

Projekti T3 - Rehabilitimi i 50 termonënstacioneve të shpërndarjes	
Rajoni	**Numri i termonënstacioneve të rehabilituara**
Ulpiana	10
Dardania	10
Qendër	12
Kodra e Diellit	10
QKUK	8
Total	**50**

Tabela: 7 Rehabilitimi i 50 nënstacioneve

2.5.4.2. Projekti T4 "Rehabilitimi i rrjetës së tubacioneve të ngrohjes në qytet"

Në këtë projekt është bërë rehabilitimi i 13 segmenteve të rrjetit primar nga gjithësejt 15 që kanë qenë të planifikuara, në pjesët kryesore të qytetit, në gjatësi prej rreth 4.5 km trase.

Projekti përfshinë: furnizim me materiale dhe pajisje, shërbimi i instalimit, punët ndërtimore, testimet, etj. Në tabelat e mëposhtme është paraqitur lista e segmenteve në të cilat janë kryer punimet për Rehabilitimin e rrjetës së tubacioneve.

	Projekti T4	Rehabilitimi i rrjetës së tubacioneve të ngrohjes në qytet	Gjatësia e tubacionit
Nr.	**Segmenti**	**Emertimi I degezimit**	**m (gyp)**
1	Segmenti 10	Deg Farmed- Deg. Fak teknik- DN 250	**400**
2	Segmenti 9	Deg. Termokos- Hotel baci DN 500	**520**
3	Segmenti 6	Deg. Pallati i rinise- OSCE DN 350	**500**
4	Segmenti 5	Deg. Pallati i Rinisë DN 250	**270**
5	Segmenti 3	Deg. Pompa e R.S. - Gjyk. Kushtet. DN 450	**800**
6	Segmenti 4	Deg. Gj. Kushtetuese -Pallati i rinise DN 400	**1,100**
7	Segmenti 7	OSCE – Shtepia e shendetit DN 350	**250**
8	Segmenti 2	Deg. Iber Lepenc - Pompa e R.Sad. DN 500	**1,400**
9	Segmenti 14	Deg. Shkolla Dardania 3/1 DN 300	**1,542**
10	Segmenti 15	Deg. Shkolla Dardania 3/1 DN 250	**548**
11	Segmenti 8	Deg. B	**430**
12	Segmenti 11	Deg. Kodra e Diellit - NST kryesor	**400**
13	Segmenti 13	Deg. ZL 13- ZL 10	**260**
Totali			**8,420 m (gyp)**

Tabela: 8 Paraqitja e segmenteve në të cilat janë kryer punimet per rehabilitimin e rrjetës së tubacioneve

Projekti T3 dhe T4 në vlerë prej 4,3 milion euro, është financuar me 4 milion euro nga KfW, ndërsa pjesa tjetër është mbuluar me donacionet nga Komuna së Prishtinës.

2.5.5. Projektet investive të realizuara gjatë vitit 2018

Ndërrimi i rrjetit të Distribuimit në dy segmente me prioritet i cili financohet nga bashkëpunimi i Qeverisë Gjermane dhe KfW-së. Ky Projekt i cili është në realizim e sipër , është vazhdimësi e projektit të kogjenerimit, faza 4 (T4) .Ne tabelën në vijim paraqitet projekti për rehabilitimin e rrjetit financuar nga Bashkëpunimi i Qeverisë Gjermane dhe KFW-së

Projekti për ndërrim të rrjetit				
	Pozicioni	Diametri/ DN	Gjatësia / m trasë	Burimi I financimit
Segmenti 1	Termokos-Ibër Lepenc	DN600	550	KFW – 1 milion euro
Segmenti 12	Nënstaconi kryesor i Kodrës së Diellit deri te Zona e Lindjes	DN400 DN350	100 875	
Total :			**1 525m trasë**	

Tabela: 9 Ndërrimi i rrjetit gjatë vitit 2018

Në kuadër të Segmentit 1 (Termokos-Ibër Lepenc) , kanë mbetë pa u përfunduar punimet për rehabilitimin e rrjetit në gjatësi prej 270m trasë, diametri i gypit DN600, në vlerë prej 0.5 milion euro. Këto punime planifikohet të përfundohen deri në tetor të vitit 2019.

3. Problemet dhe sfidat në rrjetin e shpërndarjes

Përveç rezultateve të përmendura me lartë, në periudhën e kaluar janë identifikuar edhe disa probleme në lidhje me funksionimin e tërësishëm të sistemit të NQ Termokos dhe furnizimin cilësor të ngrohjes.

3.1. Vjetërsia e gypave të rrjetit të shpërndarjes

Edhe pse, humbjet e ujit në krahasim me sezonën e kaluar janë më të ulëta, prapëseprapë, humbjet në rrjetin shpërndarës mbeten ende të larta. Humbjet e ujit në baza ditore janë rreth 10% e sasisë së përgjithshme të vëllimit të rrjetit dhe gjatë një sezone rrjeti rimbushet rreth 23 herë. Kjo vjen si rezultat i vjetërsisë së gypave të rrjetit, rreth 50% e të cilëve janë të instaluar në vitet 70-ta. Gypat e vjetruar, sidomos në disa segmente të rrjetit magjistral, ka bërë të pamundur ngritjen e presionit punues në rrjet dhe ofrim të parametrave të nevojshëm për ngrohje kualitative në termonënstacione.
Me rehabilitimin e rrjetit pritet të arrihet redukimi i humbjeve të ujit dhe si rrjedhojë arrihen këto objektiva:

- Zvogëlimi i humbjeve të energjisë nën nivelin 8 %,
- Furnizim i pandërprerë, cilësorë dhe i sigurt me ngrohje,
- Rritje e kualitetit të shërbimeve, përformancë ambientale dhe efikasitet të punës së sistemit të ngrohjes, përmes balansimit të rrjetit dhe instalimit të sistemit SCADA për monitorim dhe kontrollë nga distanca.

3.2. Rrjeti i pabalancuar

Ndër arsyet kryesore që Termokosi nuk ofron nxemje me kualitet të njejtë për të gjithë konsumatorët, përveç karakteristikave (lartësive) gjeografike të rajoneve të qytetit, është rrjeti i pabalancuar nga aspekti hidraulik dhe termik.

Në vitin 2016 është bërë implementimi i projektit për rehabilitimin e 50 nënstacioneve termike. Rehabilitimi, si qëllim primarë ka pasur instalimin e pajisjeve për matje, kontrollë dhe rregullim të rrjedhjes së ujit të ngrohtë të nënstacioneve. Efektet e këtij investimi janë inkurajuese dhe vënë në pah faktin se me rregullim të nënstacioneve mund të kursehet energji dhe njëkohësisht të gjithë konsumatorët të kenë shërbim kualitativ.

3.3. Vjetërsia e nënstacioneve

Problematikë është pjesa e 361 nënstacioneve të cilët ende mbeten të pa rehabilituara dhe të pa modernizuara, tek të cilët pjesa më e madhe e këmbyesëve të nxehtësisë për shkak të vjetërsisë, shpesh rrjedhin apo kanë rënie të koeficientit të shfytëzimit dhe rrjedhimisht edhe dobësim të kualitetit të ngrohjes në objektet e caktuara. Me projektin e Komisionit Europian janë paraparë të rekonstruohen dhe modernizohen 100 nënstacione, të cilat planifikohen të kryhen në dy vitet e ardhshme.

3.4. Vjetërsia e rrjetit sekondar

Rrjeti sekondar është përgjegjësi e konsumatorëve, pasi që, bazuar në Ligjin e Energjisë Termike, përgjegjësia e Termokosit përfundon në termonënstacion më konkretisht te këmbyesi i nxehtësisë, si pikë e fundit -ndarëse në mes sistemit sekondar dhe primar.

Në shumicën e objekteve, rrjeti sekondar është i vjetër dhe shumë i dëmtuar për shkak të mosmirëmbajtjes apo me mbushje direkte nga ujësjellësi, pa përdorur ujë të zbutur kimikisht. Deri më tani Termokosi, në mungesë të kështillave banesore (shoqatës së pronarëve të ndërtesave në bashkëpronësi), ka qenë i detyruar të mirëmbajë edhe pjesën sekondare duke intervenuar në këtë rrjet sipas kërkesave të banorëve, bazuar në tarifat e aprovuara nga ZRRE.

Problem më i theksuar në këtë pjesë mbetet mosfunksionimi i pajisjeve dhe rrjetit të sistemit sekondar, si: valvolat e trupave ngrohës, trupat ngrohës, vertikalet, etj.

Prandaj, për shkak të mosfunksionimit të tyre, shpesh detyrohemi që të bëjmë zbritje të veçanta në faturim për konsumatorët që kanë këto probleme në sistemin e ngrohjes në banesat e tyre.

3.5. Kualitet më i dobët i ngrohjes në rajonin e Kodrës së Diellit

Problemi më i theksuar viteve të fundit është cilësia jo e mirë e ngrohjes në rajonin e Kodrës së Diellit, për faktin se kjo pjesë e rrjetit të qytetit ndodhet në pjesën më të lartë gjeografike dhe si rrjedhojë ngrohet në mënyrë indirekte, rrespektivisht nëpërmjet nënstacionit kryesor për Kodrën e Diellit me fuqi prej 4x11MW=44 MW, i cili ndodhet në afërsi të Fakultetit Teknik, ku bëhet shkëmbimi i nxehtësisë dhe pompimi shtesë.

Për dallim nga shumica e konsumatorëve që janë të kënaqur me shërbimet e ngrohjes, edhe përkundër investimeve dhe disa testimeve për funksionimin më të mirë të ngrohjes, prapë se prapë një pjesë e rajonit të Kodrës së Diellit furnizohet me ngrohje me kualitet më të ulët. Rrjedhimisht, kjo na obligon që konsumatorët e këtij rajoni, për shkak të ngrohjes jocilësore, të faturohen me zbritje.

Njëra nga arsyet teknike është edhe pamundësia e ngritjes së presionit në rrjet për shkak të vjetërsisë së gypave magjistral në disa pjesë të rrjetit të qytetit, e që reflektohet drejtëpëdrejt te konsumatorët e rajonit Kodra e Diellit.

3.6. Pikat (segmentet) kritike të rrjetit të shpërndarjes

Një pjesë e konsiderueshme e gypave magjistral me dimensione të mëdha nga DN 250-DN 500, janë ndërruar gjatë viteve 2016 dhe 2018 , përveç një degëzimi, që do të përfundohet deri në tetor të vitit 2019 në kuadër të fondeve të KFW.

Pjesa tjetër e rrjetit në të cilën janë identifikuar segmentet kritike, kryesisht janë dimensione më të vogla nga DN 100 deri DN 250, me gypa çeliku të pa-izoluar. Një pjesë e tyre është paraparë të ndërrohen gjatë viteve 2019-2021, në kuader të fondeve të Komisionit Europian dhe ato janë paraqitur në tabelën vijuese:

Nr.	Adresa Prej -deri	Regjioni	Ekzistues GypØ[DN]	Planifikuar GypØ[DN] Kërkuar	Gjatësia m / trasë
1	Nga Puseta 15-deri te Puseta 17	Dardania	DN250	DN250	142
2	Nga Puseta 17-18-19-24-25-26-27-28	Dardania	DN200	DN250	289
3	SH.F. "Dardania"	Dardani	DN100	DN100	330
4	Nga Puseta 157-158-159-160-161-162-163-164	Qendra	DN350	DN350	750
5	Nga Puseta 164 deri te kyçja e Bibliotekës	Qendra	DN200	DN250	155
6	Nga Puseta 164-165-166(Mbrapa Rektoratit)	Qendra	DN200	DN200	150
7	Kuvendi komunal	Qendra	DN100	DN100	160
8	Degëzimi për Qafa ABC	Qendra	DN125	DN150	215
9	Degëzimi për Lulishte	Qendra	DN125	DN150	250
10	Tregtia e Kosovës	Qendra	DN200	DN200	125
11	Degëzimi për Solitera	Ulpiana	DN100	DN125	360
12	Kalimi I rrugës te "Hotel Baci"	Ulpiana	DN500	DN500	130
13	Nga Puseta 250-257-Rruga 1	Kodra e Diellit	DN200	DN250	200
14	TNS Kryesor deri te blloku 5	Kodra e Diellit	DN150	DN150	504
15	TNS Kryesor deri te blloku 3	Kodra e Diellit	DN150	DN150	320
16	TNS Kryesor deri te blloku 1	Kodra e Diellit	DN150	DN150	430
17	Nga Puseta 250 deri te Lagjia e Universitetit	Kodra e Diellit	DN150	DN150	455
18	TNS kryesor deri te blloku 3	Kodra e Diellit	DN125	DN125	165
19	TNS kryesor deri te blloku 1	Kodra e Diellit	DN125	DN125	110
20	TNS kryesor deri te blloku 1	Kodra e Diellit	DN100	DN100	100
21	Nga Puseta 250 deri te Lagjia e Universitetit	Kodra e Diellit	DN125	DN125	420
Total : 5 760 m trasë					

Tabela: 10 Pikat (segmentet) kritike të rrjetit të shpërndarjes

3.7. Mungesa e pompës së tretë në Stacionin e pranimit të nxehtësisë (HRS)

Sipas dizajnit fillestar, në HRS janë planifikuar tri pompa qarkulluese me kapacitet 1300m³/h për secilën. Në mungesë të fondeve, janë instaluar vetëm dy pompa. Meqenëse Termokosi planifikon zgjerimin e rrjetit dhe rritjen e konsumit, fillimisht deri në 140MW_{TH}, aq sa lejojnë këmbyesit në HES dhe rrjeti transmetues i kogjenerimit, është e domosdoshme instalimi i pompës së tretë. Për këtë pompë është rezervuar hapsira si dhe pikat për kyçje në kolektorët përkatës në HRS.

4. Analiza e konsumit të energjisë termike dhe parashikimi i kërkesës

4.1. Analiza

Për t'i paraprirë parashikimit të kërkesës për energji termike për periudhën afatgjate planifikuese, është bërë një analizë e konsumit të energjisë termike e cila përfshinë një periudhë 5 vjeçare / sezona të kaluara, duke përfshirë edhe konsumin aktual.

Në Analizën e konsumit të energjisë termike, është përfshirë:

- Konsumi sipas sezoneve të ngrohjes (në MWh);
- Kërkesa për kapacitet të konsumatorëve – kapacitetin mesatarë për sezon dhe kapacitetin maksimal (të pikut) [Në MW];
- Sipërfaqet për ngrohje;
- Numri i konsumatorëve;
- Llogaritja e Konsumit specifik për m^2 të sipërfaqes ngrohëse dhe kapacitetit specifik për m^2 .

4.1.1. Konsumi aktual dhe paraprak

Pas funksionalizimit të kogjenerimit ku është arritur një furnizim më cilësorë, konsumi në vazhdimësi ka shënuar rritje.
Të dhënat për furnizimin / konsumin gjatë sezoneve të kaluara janë paraqitur në tabelën e mëposhtme :

Sezona	Te prodhuara	Te liferuara / Konsumi	Humbjet	% e Humbjeve
	MWh $_{TH}$	MWh $_{TH}$	MWh $_{TH}$	%
2013/2014	51,528.21	41,804.43	9,723.79	19%
2014/2015	158,068.08	127,889.79	30,198.28	19%
2015/2016	198,686.00	165,087.45	33,598.55	17%
2016/2017	225,438.00	196,462.20	28,975.80	13%
2017/2018	223,738.00	199,861.75	23,876.25	11%

Tabela: 11 Energjia e prodhuar, liferuar dhe humbjet

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur numri i konsumatorëve, për pesë sezonat e kaluara;

Numri i konsumatorëve					
Sezona ngrohëse	**2013/2014**	**2014/2015**	**2015/2016**	**2016/2017**	**2017/2018**
Konsumatorët Shtëpiak	10,732	11,125	11,578	11,872	12,299
Konsumatorët Biznesor dhe Institicional	610	726	805	997	1160
Total	**11,342**	**11,851**	**12,383**	**12,869**	**13,459**

Tabela: 12 Numri i konsumatorëve

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur sipërfaqja ngrohëse, për pesë sezonat e kaluara;

Sipërfaqja ngrohëse m²					
Sezona ngrohëse	**2013/2014**	**2014/2015**	**2015/2016**	**2016/2017**	**2017/2018**
Konsumatorët Shtëpiak	632,417.10	655,773	685,130	698,602	728,530.27
Konsumatorët Biznesor dhe Institucional	391,708.41	394,106.15	476,225.90	506,715.45	542,268.03
Total	**1,024,125.51**	**1,049,879**	**1,161,356**	**1,205,318**	**1,270,798.30**

Tabela: 13 Sipërfaqja ngrohëse

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur konsumi specifik i përllogaritur për m^2 të sipërfaqes ngrohëse, në bazë të llojit të konsumatorëve.

Sezona 2017/18	Sipërfaqja /m^2	Konsumi/MWh_{TH}	Konsumi specifik për sezonë kWh_{TH}/m^2
Konsumatorët Shtëpiak	728,530.3	117,136.32	160.78
Konsumatorët Biznesor dhe Instiicional	542,268.0	82,725.38	152.55
Total	**1,270,798.3**	**199,861.75**	**157.27**

Tabela: 14 Konsumit specifik për sezonë

Diagramet e mëposhtme tregojnë kërkesën mujore për ngrohje në rrjetin e Termokosit për vitet e kaluara, përfshirë një pikëvështrim për sezonën 2017/2018.



Fig. 8 Energjia termike mujore (për sezonë) e dërguar në rrjetin e shpërndarjes së Termokosit

Figura e mëposhtme tregon kërkesën për ngrohje në rrjetin e Termokosit për katër sezonat e kaluara.



Figura 9: Energjia termike mesatare (për sezonë) e dërguar në rrjetin e Termokosit

Kërkesa aktuale për energji termike në rrjetin e shpërndarjes së Termokosit, vlerësohet se arrinë në përafërsisht 225 GWh_{TH} për sezonë. Vlerësimet e parallogaritura tregojne se rreth 25 GWh_{TH} janë humbjet e energjisë termike, kështu që afërsisht 200 GWh_{TH} i shpërndahen konsumatorëve. Kërkesa specifike për ngrohje shkon në 124 kWh_{TH}/m^2. Kjo është gjithashtu shifër e ulët veçanërisht duke marrë parasysh që furnizimi me ngrohje është i shtyrë nga prodhimi.

4.1.2. Kapaciteti i shfrytëzuar dhe në dispozicion

Në tabelën 11, është paraqitur Kërkesa për kapacitet të konsumatorëve për katër sezona , në të cilën janë përfshirë:

- Kapaciteti elektrik për sezonë (MWh/h_{EL}),
- Energjia termike e realizuar per sezonë (MWh_{TH}),
- Kapaciteti mesatar termik (MW_{TH}),
- Kapaciteti termik maksimal (të pikut) në (MW_{TH})

Sezona	Kapaciteti elektrik për sezonë (MWh/h EL)	Energjia termike e realizuar per sezonë (MWh_{TH})	Kapaciteti mesatar termik (MW_{TH})	Kapaciteti termik maksimal (të pikut) (MW_{TH})
2014/2015	24 352	152 397	47	80.4
2015/2016	30 745	198 696	46	90.8
2016/2017	34 837	225 438	52	83.8
2017/2018	34 532	223 738	52	73.9

Tabela: 15 Kërkesa për kapacitet elektrike dhe termike

***Në sezonat 2014/15 dhe 2015/2016 janë bërë teste të përformancës së sistemit, prandaj ngarkesa e regjistruar për pikun ditor nuk është ngarkesë reale e kërkuar nga konsumatorët në atë kohë.*

Aktualisht furnizimi me ngrohje është i shtyrë nga prodhimi, prandaj kapaciteti është konstant. Kjo ilustrohet në figurën vijuese ku paraqitet shfrytëzimi i kapacitetit në një ditë tipike sezonale. Siç mund të vërehet nga diagrami, kapaciteti maksimal për ngrohje arrinë deri në 70 MW, ndërsa kapaciteti i humbjeve të ngrohjes arrinë deri në 10 MW_{TH}, kështu që vetëm 60 MW_{TH} kapacitet termik i ofrohen konsumatorëve me një hapësirë totale të ngrohjes prej 1,334.000 m^2.
Kapaciteti specifik i ngrohjes është vetëm 45 W/m^2 e që është shifër shumë e ulët. Nënstacionet nuk janë të kontrolluara dhe rrjeti i qytetit nuk është i balancuar. Kështu që, ndërtesat afër Termokosit tejngrohen dhe temperatura e kthimit është tepër e lartë, ndërsa në ndërtesat që gjenden më larg Termokosit, nuk ofrohet ngrohje e mjaftueshme.



Fig. 9 Situata aktuale (faza 1)

Në diagramin vijues (figura 10) paraqiten kapacitetet mesatare mujore sipas sezonave. Duke krahasuar kapacitetet termike mesatare mujore për katër sezonat e kaluara, vlera më e madhe e kapacitetit termik mesatar ka arritur në 60 MW_{TH} në muajin janar të sezonit 2017/2018.



Fig. 10 Kapacitetet termike mesatare mujore

Ngarkesa aktuale e pikut

Bazuar në temperaturat e jashtme në qytetin e Prishtinës, ngarkesa e pikut shfaqet gjatë muajve Dhjetor dhe Janar. Normalisht, ngarkesa e pikut në rrjet determinohet nga temperaturat e jashtme (atmosferike) dhe orarit ditor. Mëngjesi dhe mbrëmja janë itervalet me kërkesa më të mëdha për energji termike.

Që nga dhjetori i vitit 2014, ngrohja prodhohet në termocentralin Kosova B, përmes ekstraktimit të ngrohjes nga turbina me presion të ulët avulli me kapacitet maksimal prej 140 MW.

30 Janari 2016 ka qenë ditë me kapacitetin më të madh të ngrohjes prej 85MW të matur, anipse kjo ditë ka qenë një prej ditëve të ngrohta të dimrit. Ngarkesa e pikut në orën 8 të mbrëmjes me një temperaturë të jashtme prej 3°C është e pazakontë. Nuk mund të identifikohet asnjë ngarkesë piku në mëngjes, shih grafikun në figurën 12.



Fig. 11 Kapaciteti i ngrohjes dhe temperaturat e jashtme më 30 janar 2016

Grafiku në vazhdim paraqet ngarkesën e kërkuar nga konsumatorët me 23.12.2017



Fig. 12 Kapaciteti I ngrohjes dhe temperaturat e jashtme më 23.12.2017

Ngarkesa e pikut në mëngjes mund të vërehet se është (65 MW_{TH}), ndërsa ngarkesa e dytë e pikut që është në ora 20 të mbrëmjes është 75MW_{TH}, që paraqet edhe kapacitetin maksimal të ngrohjes për këtë ditë me temperaturë të jashtme deri -1°C.

4.1.3. Faktorët ndikues në kërkesën për kapacitet dhe për energji termike

Një numër faktorësh kanë ndikim përcaktues në kapacitetin termik dhe sasinë e energjisë termike. Ndër kryesorët janë: masat për përmirësimin e kualitetit të ngrohjes dhe efiçiencës së energjisë, ndikimi i projekteve zhvillimore, dhe parametrat projektues gjegjësisht temperatura projektuese.

4.1.4. Përmirësimi i kualitetit të furnizimit

Është i njohur fakti se në disa pjesë të qytetit (veçanërisht Kodra e Diellit), cilësia e ngrohjes është më e dobët. Një masë e domosdoshme për përmirësimin e furnizimit është balancimi hidraulik i sistemit dhe implementimi i kontrollit automatik në nënstacione.
Kjo masë, do të ndikoj në shfrytëzimin efikas të kapacitetit termik dhe furnizim në mënyrë të balancuar për të gjitha rajonet e shpërndarjes / furnizimit, rrjedhimisht edhe aktivizimin e 'konsumatorëve pasiv'. Vlerësimet paraprake tregojnë se kapacitetit specifik (për njësi të sipërfaqes – m^2) do të jetë 80 W/m^2 , ndërsa konsumi specific do të arrij në 160 kW/m^2 për sezonë.
Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur, sipërfaqja ngrohëse e lidhjeve ekzistuese përfshirë edhe aktivizimin e "konsumatorëve pasiv" dhe përllogaritjet përkatëse të kapaciteteve termike dhe kërkesës për energji termike.

Lidhjet ekzistuese	Hapësira e ngrohur	Kapaciteti	Kërkesa
Upiana	189 667 m^2	15 173 kW	30 347 MWh
Qendra	136 242 m^2	10 899 kW	21 799 MWh
Dardania	312 410 m^2	24 993 kW	49 986 MWh
Kodra e Diellit	214 754 m^2	17 180 kW	34 361 MWh
Institucionet	481 352 m^2	38 508 kW	77 016 MWh
Totali i lidhjeve ekzistuese	**1 334 425 m^2**	**106 754 kW**	**213 508 MWh**

Tabela: 16 Të dhënat për sipërfaqen, kapacitetin dhe kërkesën për energji



Fig. 13 Situata me IHS të kontrolluar dhe rrjet të balancuar (faza 2)

Si pasojë e mosbalancimit hidraulik të sistemit dhe pamundësisë për kontroll automatik të nënstacioneve, furnizimi i të gjitha objekteve me energji termike nuk është i njejtë. Objektet më afër ngrohtores janë të tejnxehura ndërsa ato me larg ngrohtores, posaqërisht Kodra e Diellit, kanë mungesë të theksuar të energjisë termike. Temperatura e kthimit të rrjetit primarë nga nënstacionet që janë afër ngrohtores janë të larta dhe ndikojnë në kufizimin e mundësisë së ekstraktimit më të madh të energjisë termike nga HES.

Balancimi I sistemit dhe kontrolli automatik i nënstacioneve do të evitoj këtë pengesë, me ç'rast do të jetë e mundur të distribuohet energji sipas kërkesës te të gjithë konsumatorët. Për këtë arsye, ngarkesa e pikut pritet të arrijë gjer në 117MW_{TH}.

4.1.5. Projektet zhvillimore për zgjerimin e rrjetit

Në një periudhë afat-shkurtër realizimi i projekteve për zgjerim të rrjetit (në rrjetin ekzistues dhe rrjet të ri), do të ndikoj në në rritjen e sipërfaqeve ngrohëse dhe rritjen e kapacitetit termik të angazhuar, si dhe në rritjen e kërkesës për energji termike. Në tabelën e mëposhtme janë përmbledhur të dhënat për sipërfaqet ngrohëse e kyçjeve të reja si dhe për kërkesën për kapacitet dhe energji termike.

Kyçjet e ardhshme sipas studimit të BE-së	Hapësira e ngrohur	Kapaciteti	Kërkesa
Ulpania	2 550 m²	166 kW	408 MWh
Qendra	44 420 m²	2 888 kW	7 107 MWh
Dardania	9. 40 m²	627 kW	1 542 MWh
Kalabria A	157 723 m²	9 985 kW	25 236 MWh
Kalabria C	2 906 m²	349 kW	465 MWh
Mati & QKUK	59.536 m²	3 703 kW	9 526 MWh
Totali i kyçjeve sipas studimit të BE-së	**276 775 m²**	**17 718 kW**	**44 284 MWh**

Tabela: 17 Sipërfaqja e Kyçjeve të reja, kapaciteti dhe kërkesa shtesë për energji

Kapaciteti i kyçur planifikohet të rritet me 17.7 MW, përderisa kërkesa për energji termike vlerësohet se do të rritet për 44 GWh për vit.

Për përcaktimin e kërkesës së tërësishme për kapacitet termik dhe energji termike në rrjetin e shpërndarjes, duhet të merren parasysh humbjet në rrjet.

Përshkrimi	Hapësira e ngrohur m²	Kapaciteti KWh	Kërkesa MWh
Kyçjet ekzistuese	1.334.425	106.754	213.508
Kyçjet e reja (në rrjetin ekzistues dhe zgjerim të rrjetit)	276.775	17.718	44.284
Humbjet në rrjet		10.236	25.590
Totali	**1.611.200**	**134.708**	**302.504**

Tabela: 18 Ngrohja në të ardhmen në rrjetin shpërndarës të qytetit

Tabela më lartë paraqet bazën për këtë raport. Kapaciteti maksimal do të rritet gjer në 135MW_{TH}, përderisa kërkesa për ngrohje do të rritet nga 210 GWh_{TH}/vit në 303 GWh_{TH}/vit.



Fig. 14 Situata pas dendësimit dhe zgjerimit të rrjetit (faza 3)

4.1.6. Rehabilitimi i rrjetit

Realizimi i projekteve të të rehabilitimit të rrjetit, në një periudhë afatshkurtër do të të rezultoj në zvogëlim të humbjeve, me ç'rast vlerësohet se kapaciteti termik për humbjet do të zvogëlohet nga 10MW_{TH} në 5 MW_{TH}. Kjo do të liroj një kapacitet të caktuar që vlerësohet në rreth 5MW_{TH}, e po ashtu do të këtë ndikim në kërkesën e tërësishme për energji termike. Në diagramin vijues paraqitet ndikimi i rehabilitimit të rrjetit në zvoglim të humbjeve dhe në kapacitetin termik.



Fig. 15 Situata pas rehabilitimit të rrjetit (faza 4)

4.1.7. Implementimi i faturimit bazuar në matjen e konsumit

Implementimi më i gjerë i faturimit sipas konsumit të matur do të rezultoj në kursimin e energjisë, gjithashtu edhe në kapacitetin e shfrytëzuar. Ky kursim, vlerësohet të jetë në nivelin prej 23% të konsumit të energjisë termike.

Fakturimi i bazuar në shpenzim real (të matur), do t'u mundësonte konsumatorëve të kontrollojnë nivelin e ngrohjes sipas kërkesave të tyre. Konsumatorët do të zvoglojnë konsumin sidomos gjatë pikut të natës dhe në orët e mesditës. Faktori i njëkohshmërisë do të jetë i vetkontrolluar, pasiqë të gjithë konsumatorët nuk do të lëshojnë ngrohjen njëkohësisht. Ky efekt, ndikon në reduktim të ngarkesës së pikut deri në rreth 80%. Prandaj, në këtë rast, furnizimi me ngrohje është i nxitur nga kërkesa.

Në digramin e mëposhtëm paraqitet ndikimi i kursimit të energjisë në redukimin e kapacitetit termik në periudha të ndryshme kohore.



Fig. 16 Situata pas implementimit të faturimit të bazuar në shpenzim real (faza 5)

4.1.8. Deponimi i ngrohjes

Deponimi i rezervave të ngrohjes do të arrihet duke bërë akumulimin e energjisë gjatë natës, ndërsa rrjeti do të furnizohet gjatë kohës së pikut, në mëngjes dhe në mbrëmje. Efekti i deponimit të rezervave ndikon në reduktimin e ngarkesës së pikut rreth 6 MW_{TH}.

Kapaciteti i deponimit të ngrohjes do të arrijë në 45 MWh_{TH}. Bazuar në dallimet e temperaturave prej 50 K, deponimi do të ketë një vëllim prej 800 m^3. Kapaciteti rezervë bazuar në ekstraktimin e ngrohjes prej 140 MW_{TH} nga TC Kosova B do të shkoj në total 41 MW_{TH}, siç është cekur në fillim të këtij kapitulli.



Fig. 17 Situata pas implementimit të deponimit (faza 6)

Ndikimi i të gjithë faktorëve / masave të lartë-përshkruara është evident edhe në kërkesën për energji termike, e cila paraqitet në diagramin në vijim sipas fazave të implementimit të këtyre masave.



Fig. 18 Parashikimet e kërkesës për energji termike sipas fazave

4.1.9. Kapaciteti në dispozicion (rezervë)

Kapaciteti termik në dispozicion (rezervë) gjithashtu ndryshon varësisht nga implementimi i masave. Në vijim janë paraqitur vlerësimet për kapacitetin në dispozicion.

Kapacitetit i shfrytëzuar dhe rezervë, varet nga realizimi i kyçjeve me projektin e BE-së dhe implementimin e masave siç përshkruhet në kapitujt e mëhershëm.

Faza/Përshkrimi	Kapaciteti
1 / Ngarkesa maksimale aktuale	70 MW_{TH}
2 / Ngarkesa maksimale me HIS të kontrolluar dhe rrjet të balancuar	117 MW_{TH}
3 / Ngarkesa maksimale me implementimin e dendësimit dhe zgjerimit të rrjetit	135 MW_{TH}
Kapaciteti rezervë	5 MW_{TH}

Tabela: 19 Vlerësimet e kapacitetit

Siç është përshkruar më lartë, me implementimin e disa masave arrihet zvogëlimi i kapacitetit termik të angazhuar, që nënkupton se lirohet një kapacitet rezervë shtesë dhe krijohet mundësia për zgjerimin e mëtutjeshëm të rrjetit, përkatësisht kyçjen e sipërfaqes ngrohëse shtesë.

Faza/Masat	Kapaciteti rezervë
4 / Rehabilitimi i rrjetit	5 MW_{TH}
5 / Kalimi nga fakturimi i bazuar në metër katror në fakturim të bazuar në shpenzim real	25 MW_{TH}
6 / Deponimi i energjisë termike	6 MW_{TH}
Totali i kapacitetit rezervë	36 MW_{TH}

Tabela: 20 Kapaciteti rezervë shtesë

Totali i kapacitetit rezervë pas implementimit të të gjitha masave do të jetë:

Kapaciteti rezervë – masat 1-3: 5 MW_{TH}
Kapaciteti rezervë – masat 4-6 : 36 MW_{TH}
Totali i kapacitetit rezervë: 41 MW_{TH}

Duke e marrë parasysh 5% të humbjeve totale të ngrohjes për rrjetet e reja dhe faktorin e shfrytëzimit prej 80%, ky kapacitet rezervë prej 41 MW paraqet një :

→ kapacitet për kyçjen e konsumatorëve të rinjë prej 49 MW_{TH}.

4.2. Parashikimi i Kërkesës për energji termike për periudhën 2019-2029

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur planifikimi për periudhën dhjetëvjeçare (sezonat ngrohëse), duke përfshirë edhe sezonën e fundit 2017/2018, e cila përmbanë parashikimet për:

1. Ngarkesa maksimale /MW_{TH},
2. Konsumin e energjisë /MWh_{TH}
3. Kapaciteti I rezervuar elektrik MWh_{EL}/h - (Vjetore),
4. Energjia e liferuar/MWh_{TH},
5. Humbjet ne rrjetin e shperndarjes/MWh_{TH},
6. Sipërfaqja/m^2.

Në tabelën nr.21 është paraqitur Planifikimi i konsumit, humbjeve të energjisë termike dhe rritjes së sipërfaqes, për periudhën 2018-2028 (për sezonë ngrohëse).

Planifikimi I konsumit, humbjeve të energjisë termike dhe rritjes së sipërfaqes , për periudhën 2018-2028 (për sezonë ngrohëse)										
Sezona	2019 / 20	2020 / 21	2021 / 22	2022 /23	2023 / 24	2024 / 25	2025 / 26	2026 / 27	2027 / 28	2028/29
Ngarkesa maksimale /MW_{TH}	92	105	115	120	130	140	140	140	140	140
Prodhimi i energjisë termike /MWh_{TH}	278,160.00	317,466.00	347,700.00	362,818.00	393,053.00	423,288.00	423,288.00	423,288.00	423,288.00	423,288.00
Kapaciteti i rezervuar elektrik MWh/h (Vjetore)	42,402.00	48,394.00	53,003.00	55,307.00	59,916.00	64,525.00	64,525.00	64,525.00	64,525.00	64,525.00
Energjia e furnizuar /MWh_{TH}	250,344.00	288,894.00	316,407.00	330,164.00	361,608.00	389,424.00	393,657.00	393,657.00	393,657.00	393,657.00
Humbjet ne rrjetin e shperndarjes/MWh	27,816.00	28,571.00	31,293.00	32,653.00	31,444.00	33,863.00	29,630.00	29,630.00	29,630.00	29,630.00
Sipërfaqja/m^2	1,597,195.0	1,843,144.0	2,018,677.0	2,106,449.0	2,307,064.0	2,484,531.00	2,511,537.0	2,511,537.0	2,511,537.0	2,511,537.0

Tabela: 21 Planifikimi për konsumin e energjisë dhe rritjen e sipërfaqes

5. Planifikimi për zhvillimin e rrjetit / sistemit

Planifikimi për zhvillimin e rrjetit / sistemit të ngrohjes qëndrore të NP"Termokos", është mbështetur kryesisht në Dokumentin e Master Planit dhe në Strategjinë e energjisë së Republikës së Kosovës (2017-2026).

Kërkesat për kyçje të reja në sistemin e ngrohjes qendrore, duhet të analizohen në bazë të të dhënave të Masterplanit dhe të aprovohen vetëm nëse janë në përputhje me kriteret dhe arsyeshmëritë e përcaktuara për këtë lloj të investimeve. Përcaktimi i prioriteteve të paketave investuese, qofshin ato donacione apo mjete vetanake, është vendimtare për të siguruar që përfundimi i këtyre paketave investuese të bëhet me sukses të plotë. Rruga më efektive e përdorimit të fondeve është katergorizimi paraprak i paketave investuese, nga ato me prioritet më të lartë në atë me prioritet më të ulët.

5.1. Faktorët kryesor në planifikimin e projekteve zhvillimore

Faktorët kryesorë në të cilët është bazuar planifikimi i projekteve zhvillimore janë:

- Kapaciteti aktual në dispozicion i kogjenerimit prej 140 MW_{TH} duhet të shërbej si bazë për realizimin e objektivave të cilat dalin nga Plani zhvillimor.
- Llogaritja e kërkesës për energji termike gjatë ngarkesës së pikut dhe energjia përkatëse e sistemit aktual të ngrohjes qendrore, duke marrë parasysh kapacitetet rezervë, kushtet reale të klimës në Prishtinë gjatë sezonit të ngrohjes (temperatura projektuese), si dhe investimet e ardhshme në zgjerimin dhe rehabilitimin e rrjetit.
- Propozimi dhe vlerësimi financiar për masat shtesë të rehabilitimit të rrjetit, për të ulur më tej humbjet e energjisë, bazuar në llojin e izolimit, metodës së instalimit dhe vjetërsisë së gypave, në vlera të pranueshme në aspektin teknik dhe ekonomik.
- Skenari i mundshëm për rritjen e kapaciteti kogjenerimit deri në 280 MW_{TH}, duke marrë parasysh investimet e mundshme në këmbyesit e nxehtësisë (HES dhe HRS) dhe tubacionin kryesor transmetues.
- Supozimi bazik në lidhje me kapacitetin prej 280 MW_{TH} është se ky kapacitet do të sigurohet edhe pas dekomisionimit eventual në të ardhmen të TC Kosova B, pasi termocentrali Kosova e Re do të ofrojë mundësinë për bashkë-prodhim të energjisë elektrike dhe termike (sistem të kogjenerimit).

5.2. Objektivat e Planit Zhvillimor

Me këtë plan zhvillimor synohet të arrihen këto objektiva strategjikë:

1. Shfrytëzimi maksimal i kapaciteteve ekzistuese të sistemit të energjisë termike (ngrohjes qendrore) dhe zhvillimi i kapaciteteve të reja;
2. Sigurimi i furnizimit të qëndrueshëm dhe cilësor me energji termike për qytetin e Prishtinës;
3. Plotësimi i caqeve dhe obligimeve të efiçiencës së energjisë, duke favorizuar sistemin e kogjenerimit si formë më e mirë dhe efiçiente për prodhimin e energjisë termike dhe me impakt të madh në mbrojtje të mjedisit.

5.3. Masat kryesore për arritjen e objektivave të Planit zhvillimor

Masat kryesore të nevojshme për rritjen e objektivave të përcaktuara në '5.2' janë:

- Zgjerimi i kapaciteteve ekzistuese të sistemeve të energjisë termike dhe përgatitja e kushteve të nevojshme për ndërtimin e sistemeve të reja;
- Përmirësimi i përgjithshëm i efiçiencës së energjisë dhe përmbushja e obligimeve karshi TKE-së dhe MSA-së për këtë fushë;
- Shfytëzim më të madh të burimeve të tjera të energjisë në dispozicion, kryesisht të burimeve të energjisë së ripërtërishmesi dhe përmbushja e obligimeve ndaj TKE-së dhe MSA-së për këtë fushë.

5.3.1. Zvogëlimi i humbjeve dhe kursimi i energjisë

Projektet që do të realizohen në këtë periudhë, përveç objektivave të potencuara më lartë, kanë për qëllim zvogëlimin e humbjeve të energjisë në rrjet dhe kursimin e saj përmes masave të efiçiencës. Në kuadër të kësaj përfshihet edhe zvogëlimi i humbjeve të ujit (nga rrjedhjet e ujit në tubacione)

Humbjet e ujit në rrjetin distributiv të qytetit janë të mëdha dhe ndikojnë drejtpërdrejt në kualitetin e shërbimit dhe përformancën e ndërmarrjes. Planifikohet që që këto humbje, nga rreth 12% që janë aktualisht, në fund të kësaj përiudhe të zbriten nën 10%. Me zvogëlimin e humbjeve, rrjedhimisht me kursimin e energjisë do të rritet mundësia që Termokosi, me të njëjtat kapacitetete, të furnizoj më shumë konsumatorë.

5.3.2. Masat e shfrytëzimit efiçient të energjisë termike

Është evidente se në këtë drejtim ka shumë mundësi të përmirësohen gjërat. Masat më ndikim kryesorë në operim efiçient janë:

- Rehabilitimi i nënstacioneve termike.
- Rehabilitimi i nënstacioneve nënkupton edhe marrjen e të gjitha masave për aftësimin e rregullimit automatik dhe matjes së energjisë termike. Në këtë mënyrë do të bëhet balancimi hidraulik dhe energjetik i rrjetit dhe si rezultat furnizimi i të gjithë konsumatorëve me energji të nevojshme sipas standardeve.
- Gypat e paraizoluar të cilët do të instalohen në rrjetin e rehabilituar, përveç zvogëlimit të humbjeve të ujit, do të ndikojnë edhe në zvoglimin e humbjeve të energjisë si rezultat i izolimeve termike të gypave sipas standardeve.
- Përmirësimi i termoizolimit të objekteve të vjetra, publike dhe private, është një mundësi e mirë për kursim të energjisë termike. Konsumatorët e rinjë, të cilët planifikohen të lidhen në rrjetin e Termokosit, kanë standard të pranueshëm sa i përket termoizolimeve. Në këtë drejtim, duke patur në rrjetin e vet konsumatorë të cilët i plotësojnë standardet e efiçiencës termike, Termokosi e sheh mundësinë e rritjes së konsumatorëve duke shfrytëzuar të njëjtat potenciale gjeneruese.

5.3.3. Masat prioritare për përmirësim të cilësisë së ngrohjes

- Implementimi i matësve të ngrohjes dhe sistemit të kontrollit në të gjitha nënstacionet;
- Implementimi i nënstacioneve me kontroll automatik me matës të ngrohjes në nivel ndërtesash;
- Mbajtja në gjendje gatishmërie e kaldajave me mazut, për mbështetjen e furnizimit me ngrohje, në rast të pamundësisë së furnizimit nga TC Kosova B;
- Kalimi nga furnizimi i bazuar nga prodhimi në furnizim të bazua nga kërkesa;
- Kalimi nga fakturimi i bazuar në metër katror në fakturim të bazuar në konsumin e matur;
- Implementimi i procedurës për arkivimin e të dhënave duke përdorur SCADA ekzistuese, dhe duke mundësuar kësisoj historikun e të dhënave në p.sh format excel për procesim më të lehtë;
- Matja e ngrohjes së transferuar nga të gjitha nënstacionet në ndërtesa, për çdo orë, për të mbledhur të dhëna të qëndrueshme lidhur me humbjet e ngrohjes dhe kërkesës për ngrohje të konsumatorëve (për 50 nënstacione të reja aktualisht, por e nevojshme për të gjitha);
- Instalimi i pompës së tretë transmetuese me shëndrrues të frekuencave në HRS, kur ngarkesa e ngrohjes të tejkalon 90 MW për të siguruar mjaftueshmëri kapcitetit të pompimit.

5.3.4. Masat strategjike afatgjate

- Rindërtimi i rrjetit shpërndarës të qytetit;
- Instalimi i rezervuarit për deponim të ngrohjes;
- Rritja e kapacitetit prodhues në TC Kosova B nga 140 MW_{TH} në 280 MW_{TH};
- Sigurimi që termocentrali Kosova e Re të përfshin kapacitetin për ekstraktim të ngrohjes, prej së paku apo më shumë se 280 MW_{TH};
- Inkurajimi i konsumatorëve për të implementuar masat e efiçiencës së energjisë (EE) në ndërtesat e tyre;
- Implementimi i një sistemi për menaxhimin e energjisë.

5.3.5. Kalimi në Faturim të bazuar në shpenzim

Kapaciteti rezervë në dispozicion për zgjerimin e hapësirës për shërbime si dhe për dendsifikimin e rrjetit ekzistues, do të mvaren nga marrja e masave vijuese:

- Kalimi nga furnizimi i ngrohjes së bazuar në prodhim, në furnizim të ngrohjes të bazuar në kërkesë;
- Kalimi nga faturimi i bazuar në metra katror, në faturim të bazuar në shpenzim real (me matje);
- Riparimi i rrjetit të shpërndarjes (zvogëlimi i humbjeve të energjisë termike në rrjetin shpërndarës);
- Instalimi i rezervuarit për deponim të energjisë ('buffer tank').

Ngarkesat e pikut karakteristik, do të mbulohen vetëm në rastin e furnizimit të ngrohjes e cila bazohet në kërkesë. Vetëm kur konsumatorët të kenë mundësinë për të kontrolluar furnizimin e ngrohjes sipas kërkesës, përmes valvulave rregulluese në radiatorët e apartamenteve (me matës individual të shpenzimit) apo në kombinim me matësit e ngrohjes në nivel ndërtesash, do të mund të identifikohej piku karakteristik, në orët e hershme të mëngjesit (në mes të orës 5 dhe 8) dhe në mbrëmje (në mes orës 6 dhe 10). Pronarët e apartamenteve do të reduktonin temperaturën në apartamentet e tyre gjatë natës, p.sh. nga 21°C në 17°C, si dhe në mëngjes dhe paradite, pasiqë shumica prej tyre janë jashtë apartamenteve (p.sh për arsye të punës).

Faktori i njëkohshmërisë përshkruan faktin që jo të gjithë konsumatorët do t'a lëshojnë ngrohjen në të njëjtën kohë, p.sh në mëngjes apo pasdite. Faktori tipik i njëkohshmërisë për rrjete më të mëdha, sikurse ai i Termokosit, vlerësohet të jetë 80%, që do të thotë se 80% e të gjitha apartamenteve shfrytëzojnë ngrohjen në të njëjtën kohë. Të tjerët do të lëshojnë atë më herët apo më vonë në mëngjes, apo janë jashtë apartamentit të tyre për shkak të pushimit apo arsyeve tjera.

Efektet kryesore të furnizimit me ngrohje sipas kërkesës janë:

- Kërkesa për kapacitete nga ana e konsumatorëve do të jetë më e vogël për shkak të faktorit të njëkohshmërisë;
- Kërkesë më e vogël për ngrohje, veçanërisht gjatë natës, për shkak të reduktimit të temperaturave në dhoma;
- Mundësia e përdorimit të sasisë së deponuar që mund të akumulohet gjatë natës, për mbulim të kapacitetit të furnizimit në kohën e ngarkesës së pikut.

5.4. Metodologjia dhe kriteret për hartimin e Planit zhvillimor

Metodologjia e përdorur për hartimin e Planit zhvillimor, është bazuar në të dhënat statistikore të prodhimit dhe furnizimit të energjisë termike, kërkesave për kyçje të konsumatorëve të rinjë ,si rezultat i rritjes dhe zhvillimit të qytetit të Prishtinës, si dhe të kapaciteteve prodhuese në dispozicion dhe të zgjeruara të energjisë termike.

Bazë për hartimin e Planit zhvillimor të Termokosit është Master Plani për përmirësimin e ngrohjes në qytetin e Prishtinës, Strategjia nacionale e energjisë, si dhe dokumentet tjera zhvillimore të NP "Termokos".

Kriteret bazë për hartimin e Planit Zhvillimorë të sistemit të ngrohjes qendrore të NP"Termokos", kryesisht përfshijnë orientimin e fondeve vetanake dhe donacioneve, në atë mënyrë që të sigurohet rritje e sigurisë së furnizimit me energji termike, qëndrueshmëria teknike dhe financiare, ofrimi i shërbimeve me kualitet shumë më të lartë, rritjen e efiçiencës së energjisë, mundësinë e shfrytëzimit të burimeve të ripërtritshme të energjisë për sigurimin e prodhimit të energjisë termike dhe respektimin e normave mjedisore.

Investimet e planifikuara, të kategorizuara në pako investuese sipas prioritetit, janë dhënë në vijim:

- Rehabilitimi i rrjetit - Zvoglimi i humbjeve të energjisë;
- Densifikimi i rrjetit - Kyqja në sistem e ndërtesave në afërsi të rrjetit ekzistues;
- Zgjerimi i rrjetit – Kyqja e lagjeve të reja në sistem;

Për më tepër, çdo paketë e investimeve mund të përfshijë një ose disa kategori të konsumatorëve:

- Banesor,
- Institucional, dhe / ose
- Komercial.

Pakot e investimeve përmbajnë analizën në vijim:

- Vlerësimi i të gjitha ndërtesave të identifikuara dhe të propozuara,
- Vlerësimi i parametrave kryesorë: dimensionet, vlerat U, numrin e apartamenteve, kërkesën për ngrohje, llojin aktual të ngrohjes / karburantit, vjetërsinë etj.
- Vlerësimi social i përfituesve (kriteret që duhet të përcaktohen, p.sh. densiteti i matur në m² për person),
- Modelimi hidraulik ;
- Inkorporimi i investimeve të propozuara (ndërtesat dhe zonat e zgjerimit) në modelin hidraulik të rrjetit ekzistues (modeli, përfshirë zgjerimet e projektit të BE-së do të ofrohen nga palët e interesuara);
- Analiza e fyteve të ngushta në rrjet, shkaktuar nga investimet e reja;
- Vlerësimi i kostos së përmirësimeve të nevojshme të rrjetit (rritja e diametrit) dhe alokimi në CAPEX të projektit përkatës të zgjerimit;

5.5. Projektet e Planifikuara

Për të plotësuar kërkesat në rritje të qytetit të Prishtinës për energji, Termokosi planifikon zgjerimin dhe modernizimin e rrjetit të shpërndarjes. Në këtë drejtim, projektet kryesore për periudhën 2019-2029, të finacuara nga donatorë dhe nga mjetet vetanake, janë:

1. Projekti për rehabilitim dhe zgjerim të rrjetit, (Projekti i Komisionit Evropian),
2. Projekti për rehabilitim dhe zgjerim të rrjetit, (Projekti i Qeverisë Gjermane përmes KfW),
3. Projekti për instalimin e matësve të energjisë (Projekti - MCC),
4. Zgjerimi i sistemit të pompave qarkulluese,
5. Pompa e tretë në sistemin e kogjenerimit,
6. Projekti për implementimin e një softueri për faturim,
7. Projekti për implementimin e një softueri për burime njerezore,
8. Projekti për ndërtimin e një objekti të ri për stafin Administrativ,
9. Projekti për Furnizim me energji termike përmes energjisë diellore,
10. Ndërtimi i infrastrukturës për dyfishim të kapaciteteve prodhuese dhe rrjetit transmetues të kogjenerimit.

5.5.1. Projektet për rehabilitimin dhe zgjerim të rrjetit

Qëllimi i rehabilitimit të rrjetit është të ndërrohen të gjithë gypat e vjetër me gypa të rinj të paraizoluar si dhe të bëhet rekonstruimi dhe modernizimi i termonestacioneve të ngrohjes. Në fund të programit për rehabilitimin e rrjetit, rrjeti duhet të përbëhet vetëm nga gypat e rinjë të paraizoluar dhe me nënstacione të modernizuara me mundesi komunikimi SCADA nga distanca.
Gjatësia totale e rrjetit do të rritet aq sa t'i plotësojë kërkesat për kyçjet e ndërtesave të reja, sipas studimit të BE-së. Grafiku i mëposhtëm përshkruan zhvillimin e programit për rehabilitimin e rrjetit.



Fig. 19 Zhvillimi I rrjetit

Në vijim janë paraqitur projektet për zëvendësim të rrjetit në rajonet ku është i shtrirë rrjeti i ngrohjes qëndrore në Dardani, Qendër, Ulpianë , Kodra e Diellit dhe zonën e QKUK.

5.5.2. Projekti për rehabilitim dhe zgjerim të rrjetit (Komisioni Europian)

Projekti për rehabilitim dhe zgjerim të rrjetit, do të financohet nga fondet e Komisionit Europian në vlerë prej 8.3 mil €, Komuna e Prishtinës 0.25 mil € dhe Termokos 0.25 mil €.
Fondi prej 8.3 mil € nga Komisioni Europian është i ndarë për këtë përbërje:

- Konsulencë - 1milion €,
- Rehabilitim (zëvendsim) dhe zgjerim të rrjetit - 3.3 milion €,
- Rehabilitim të termonëstacioneve - 2.8 milion € dhe
- Nënstacione të reja - 1.2 milion €.

Në vitin 2019, në kuadër të këtij fondi është kontraktuar projekti në shumë prej 5, 672 million € për zgjerim dhe rehabilitim të rrjetit, që planifikohet të realizohet gjatë vitit 2019.

Dedikimi i mjeteve të kontraktuara është si vijon :

- për konsulencë - 0.68 milion euro,
- për rehabilitim (zëvendsim) dhe zgjerim të rrjetit - 2.25 milion euro,
- për rehabilitim të termonëstacioneve - 1.6 milion euro dhe
- për nënstacione të reja - 1.14 milion.

